1
EPITAFET NË GJUHËN OSMANE DESHIFRIMI DHE PËRKTHIMI I TYRE REGJIONI I PRISHTINËS

FAKULTETI I
STUDIMEVE ISLAME
PRISHTINË

Epitafet
në gjuhën osmane

DESHIFRIMI DHE PËRKTHIMI I TYRE

1

REGJIONI I
Prishtinës

PËRGATITI PËR BOTIM
AGRON ISLAMI
SELIM SELIMI
HATIXHE AHMETI

PRISHTINË 2017

BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ISLAMIC COMMUNITY OF KOSOVA

FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME
FACULTY OF ISLAMIC STUDIES
PRISHTINË / PRISHTINA

EPITAFET NË GJUHËN OSMANE

Deshifrimi dhe përkthimi i tyre

Regjioni i Prishtinës

EPITAPHS IN OTTOMAN LANGUAGE

Their deciphering and translating

The region of Prishtina

1

Prishtinë 2017

Titulli:
EPITAFET NË GJUHËN OSMANE -
DESHIFRIMI DHE PËRKTHIMI I TYRE -
REGJIONI I PRISHTINËS

Titulli ne Anglisht:
EPITAPHS IN OTTOMAN LANGUAGE -
THEIR DECIPHERING AND TRANSLATING -
THE REGION OF PRISHTINA

Botues:
Fakulteti i Studimeve islame - Prishtinë

Redaktor përgjegjës:
Prof asoc. dr. Fahrush Rexhepi
Dekan i Fakultetit të Studimeve Islame – Prishtinë

Redaksia:
Prof. ass. dr. Zija Abdullahu
Prof. ass. dr. Musa Vila

Recensentë:
Dr. Mustafa Küçük
Specialist i shkrimeve Osmane pranë Arkivit Osman - Stamboll

Transkriptoi dhe përgatiti për botim:
Agron Islami
Selim Selimi
Hatixhe Ahmeti

Historiku i qyteteve dhe fshatrave:
Prof. dr. Jusuf Osmani

Përshkrimi i epitafeve në osmanishte:
Agron Islami

Korrektor:
Prof. dr. Hysen Matoshi

Dizajni dhe faqosja:
Edib Agagjyshi

Shtypshkronja:
Focus Print, Shkup

ISBN 978-9951-583-08-4

Epitafet
në gjuhën osmane

DESHIFRIMI DHE PËRKTHIMI I TYRE

REGJIONI I
Prishtinës

PËRGATITI PËR BOTIM:

AGRON ISLAMI
SELIM SELIMI
HATIXHE AHMETI

YUNUS EMRE ENSTITÜSÜ

Realizimi i projektit "Epitafet në gjuhën osmane - Deshifrimi dhe përkthimi i tyre në Regjionin e Prishtinës" është mbështetur edhe nga Instituti Yunus Emre në Prishtinë.

"Priştine Yöresi Mezar Taşların Transkripsiyonu ve Çevirisi" projesi Priştine Yunus Emre Enstitüsü tarafından da desteklenmiştir.



كُلُّ نَفْسٍ ذَآئِقَةُ الْمَوْتِ

Secili njeri do të shijojë vdekjen

Kul-lu nefsin dhâikatul mevt

Âl-i Imran 3/185

Përmbajtja

Parathënie
Faqe 7

Prezantim
Faqe 10

Vështrimth epitafeve osmane
Faqe 12

1. Prishtina
Faqe 18

2. Mramori
Faqe 82

3. Banulla
Faqe 90

4. Gadime
Faqe 93

5. Janjeva
Faqe 97

6. Llukari
Faqe 106

7. Sllovia
Faqe 113

8. Truda
Faqe 117

9. Prugovci
Faqe 120

10. Podujeva
Faqe 126

11. Dumnica
Faqe 130

Parathënie / Önsöz

Prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi
Dekan i Fakultetit të Studimeve Islame - Prishtinë
İslami İlimler Fakültesi Dekanı - Priştine

Kosova kishte hyrë nën administratën osmane që nga gjysma e shekullit XV e deri në fillim të shekullit XX. Pa dyshim që gjatë kësaj periudhe populli i Kosovës dhe popujt tjerë nën administratën osmane lanë gjurmë të pashlyera tek njëri tjetri, gjurmë të cilat edhe sot kanë vlerën e vetë në jetën kulturore të këtyre popujve.

Popullata e cila jetonte në territorin e Kosovës së sotme, që nga fillimi i administrimit osman për fe kishte zgjedhur islamin. Paraardhësit tanë nga besimi islam, u kujdesën që prapa vetes të lënë edhe dëshmitë për ekzistencën e tyre në këto troje arbërore, siç është rasti i nishaneve nëpër varreza, xhami, teqe, tyrbe, çezma, ura etj., që janë një vlerë e patejkalueshme për studiuesit e historisë dhe kulturës fetare të Kosovës dhe më gjerë.

Fakulteti i Studimeve islame në Prishtine synon që përmes kuadrove profesionale të brendshme dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm të iniciojë dhe realizojë projekte të cilat hedhin dritë për të kaluarën tonë fetare, kulturore dhe

Kosova XV. yüzyıldan başlayarak XX. yüzyıllara kadar, Osmanlı idaresi altına hüküm edilmişti. Şüphesiz ki bu dönem içerisinde, Kosova halkı ve diğer halklar, Osmanlı idaresi altında, buradaki halkları birbirlerine karşı her alanda alıp verdikleri birçok şey olmuştur. Bu değerler silinmeyecek kadar derin izler bıraktılar.

Bu izler halen gün bugün toplumun kültürel değerleri olarak sayılmaktdır. Günümüzün Kosovası sınırları içinde yaşayan halk, kendilerine din olarak İslamı seçmiştir. Atalarımız İslam inancını benimseyerek arkasında bu Arbror *(Arnavutların ataları)* topraklara unutulmayacak izler bırakarak; mezar taşları, cami, teke, türbe, çeşme, köprü ve bu gibi dini, tarihi, sanatsal ve kültürel varlıklar, Kosova ve Kosova sınırları dışında kalan değerler, araştırmacılar için hali hazırda kaçınılmaz bir ortam oluşturulmuştur.

Priştine İslami İlimler Fakültemiz, fakülte içinde ve dışarıda var olan profesyonel kadrolarla ve araştırmacılarla işbirliği yaparak, Kosova Cumhuriyetin

historike në Republikën e Kosovës. Mbi vazhdën e realizimit të këtyre synimeve, sot keni në duar librin me titull *"Epitafet në gjuhën osmane - Deshifrimi dhe përkthimi i tyre në regjionin e Prishtinës",* të përgatitur nga Agron Islami, Selim Selimi dhe Hatixhe Ahmeti. Projekt i cili ka filluar në vitin 2015 dhe është punuar në mënyrë sistematike me punë në terren.

Duke njohur vlerën dhe rendësinë dokumentare të këtyre teksteve mbivarrezore për të kaluarën tonë kulturore e historike, duam që përmes fotografisë, deshifrimit dhe përkthimit t'i bëjmë të pavdekshëm dhe studiueseve/lexuesve t'u ofrojmë edhe një argument më shumë për trashëgiminë tonë kulturore dhe historike. Në veçanti kur jemi dëshmitarë të asaj se këto tekste dokumentare të gdhendura në gurë dita ditës po zhdukën nga pakujdesia dhe mos njohja e rëndësisë shkencore.

Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, për realizimin e projekteve shkencore, bashkëpunon me institucione simotra në regjion, njëherit edhe me institucione kërkimore dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit. Mbi bazën e këtyre bashkëpunimeve FSI, për realizimin e projektit të Epitafeve osmane në regjionin e Prishtinës, ka marr një mbështetje edhe nga Instituti kulturor ''Yunus Emre" në Prishtinë, gjë për të cilën u shprehim mirënjohje.

Libri *"Epitafet në gjuhën osmane - Deshifrimi dhe përkthimi i tyre në regjionin e Prishtinës",* është fillimi i një përmbledhje disa vëllimore të cilat janë në realizim e sipër dhe që mbulojnë gjithë territorin e Kosovës. Vëllimin që keni në duar, jep informacion për vazhdimësinë e jetës dhe kulturës islame në regjonin e Prishtinës duke filluar nga viti 1522 (mbishkrimi më i vjetër i gjetur në

birçok dini, kültürel sanatsal ve tarihi geçmişimizin eserlerini aydınlatmağa girişmiş ve gerçekleştirmek amacını hedef koyarak projeler hazırlamıştır. Bu projeler kapsamında, bugün elinizde bulunan *"Osmanlı Mezar Taşları – Priştine Yöresinde Mezar Taşlarının Transkripsyonu ve Çevirisi"* adlı kitabımız, Agron İslami, Selim Selimi ve Hatice Ahmeti tarafından hazırlanmıştır. Proje 2015 yılında başlamış, sistematik ve özverili bir çalışmayla hazırlanmıştır.

Mezar taşlarındaki yazıların büyük önemi olduğunu göz önünde bulundurarak, geçmişimizin tarihi ve kültürel varlığını, fotograflarla göstererek, onları transkripte edip var olan bu tarihi sanatsal ve kültürel mirasımız, araştırmcılar için ölümsüz birer kanıt olacaktır. Özellikle hepimiz şahid olduğumuz bu günlerde, maalesef, mevcut olan kültürel mirasımız bakımsızlıktan ve araştırmacıların ilgisizliğinden dolayı yok olmakla yüz yüze kalmıştır.

Priştine İslami İlimler Fakültemiz, bilimsel projelerin gerçekleştirmesi için bölgede, birçok devlet kurumlarıyla, bilimsel ve araştırma işbirliği içindedir. Fakültemiz ''Priştine Yöresindeki Mezar taşları" projesi kapsamında, yaptığı işbirliği çalışmaları çerçevesinde Priştine Yunus Emre Enstütüsünden destek almıştır, bu vesileyle şukranlarımı arz ederim.

"Osmanlıca Mezar Taşları – Priştine Yöresinde Mezar Taşlarının Transkripsyonu ve Çevirisi" adlı kitap Kosova'nın bütününü kapsayan, birçok cildin yapılacağı aşamada olan bu proje, birinci cildini oluşturarak tamamlamıştır. Elinizde bulunan kitap, geçmişte Priştine bölgesinde İslam kültürünün var olduğunu gösteren, önemli bilgileri vermektedir. Bu kapsamda en eski mezar taşı da 1522 yılına aittir ve bu asra ait mezar taşlarının bulunması da bunun en iyi bir götergesidir.

varrezat e Prishtinës) dhe vazhduar deri në shekullin tonë.

Me këtë rast dua të shpreh falënderimet e sinqerta për këshillin shkencor të Fakultetit të Studimeve Islame – Prishtinë, për mbështetjen në realizimin e projektit në fjalë, po ashtu autorët: Agron Islami dhe Selim Selimin për punën profesionale, sikur edhe recensentin, përkatësisht specialistin e shkrimeve osmane nga Arkivi Osman në Stamboll Dr. Mustafa Küçük, për kontrollimin e transkriptimit dhe vështrimin profesional mbi rëndësinë e teksteve mbivarrezore, kompaninë *"Olive Entertainment"* për fotografimin profesional të gurëve të varrezave, deshifrimi dhe përkthimi i të cilëve është pasqyruar në këtë vepër.

Bu vesileyle öncelikle İslami İlimler Fakültemizin bilimsel kuruluna, adı geçen projeyi destekledikleri nden dolayı teşekkür ederim. Ayrıca bu projenin girişimcileri olan Agron İslami ve Selim Selimi'yi yaptıkları profesyonel çalışalarından dolayı ve bu alanın uzmanı olan İstanbul Osmanlı Arşivi uzmanı Dr. Mustafa Küçük'e yaptığı değerlendirmeleri ve mezar taşlarının önemini arz ettiği için, *"Olive Entertain ment"* şirketini de mezar taşlarının fotograf çekimleri hazırladığı için teşekürlerimi sunarım.

Prezantim / Sunuş

Prof. dr. Şeref Ateş
Kryetar i Institutit Yunus Emre
Yunus Emre Enstitüsü Başkanı

Misioni kryesor i Institutit Yunus Emre është që të promovoj gjuhën dhe kulturën e Turqisë përmes bashkëpunimeve me shtetet mike të saj. Mbi këtë bazë instituti ynë organizon kurse në fusha të ndryshme të kulturës turke për gjithë të interesuarit. Instituti jonë mban emrin e një personaliteti të njohur për vlerat prej një njeriu të devotshëm, që përmes qendrave kulturore në katër anët e botës ne sot promovojmë këto vlera të gjuhës dhe kulturës sonë. Mbi këtë bazë të filozofisë së Yunus Emres ne sot kemi aktivitete kulturore në mëse 40 shtete me mbi 50 qendra kulturore. Në Kosovë përfaqësohemi me tri qendra kulturore, në Prishtinë, Pejë dhe Prizren. Përmes këtyre qendrave kulturore zhvillojmë bashkëpunime me homologët tanë me qëllim të përforcimit të pikave tona të përbashkëta kulturore dhe historike.

Epitafet janë objekte të shkruara të cilat janë dëshmi mbi vazhdimësinë e kulturës dhe arkitekturës së një populli, ato japin informacion për të kaluarën

Yunus Emre Enstitüsünün misyonu: Türkiye'yi, kültürel mirasını, Türk dilini, kültürünü ve sanatını tanıtmak, Türkiye'nin diğer ülkeler ile dostluğunu geliştirmek, kültürel alışverişini arttırmak, bununla ilgili yurt içi ve yurt dışındaki bilgi ve belgeleri dünyanın istifadesine sunmak, Türk dili, kültürü ve sanatı alanlarında eğitim almak isteyenlere yurt dışında hizmet vermektir. İnsani değerleri, insan sevgisini ve toplumsal barışı temsil etme özelliğinden dolayı adını bir Anadolu mutasavvıfı olan Yunus Emre'den alan Enstitümüz, dünyanın dört bir köşesinde Kültür Merkezleri vasıtasıyla dilimizi ve kültürümüzü tanıtmak için adımlar atmaya devam etmektedir. Bu amaç ve hedefle kurulan Yunus Emre Enstitüsü, 40 ülke ve 50 merkezle bu felsefe doğrultusunda çalışmaktadır. Kosova'da da Priştine, Prizren ve İpek'te üç kültür merkezi bulunmaktadır. Bu kültür merkezleri aracılığıyla iki dost ülke, ortak tarihten ve kültürden gelen birlikteliğini daha da pekiştirmektedir.

(historinë) dhe krijojnë ura lidhëse në mes të kaluarës dhe të sotmës. Epitafet më së miri reflektojnë pikat e përbashkëta të kulturës sonë.

Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës si institucioni më i lartë akademik dhe shkencor i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës ka realizuar projektin me titull *"Epitafet në gjuhën osmane në regjionin e Prishtinës",* me ç'rast tekstet e varrezave me mbishkrime osmane janë transkriptuar dhe përkthyer në gjuhën shqipe. Tekste të cilat janë nga burimet e dorës së parë për gjuhën, historinë, gjeografinë, topografinë dhe fushat tjera shkencore. Nxjerrja në pah e këtyre objekteve kulturore përmes botimit të tyre para se gjithash është një kontribut shkencor dhe ofron dëshmi për bashkëjetesën e popujve që nga viti (përafërsisht) 1390 e deri në ditët e sotme.

Pa u zgjatur, dua të shpreh falënderim dhe mirënjohje ekipit profesional për punën shkencore, punonjësit e Institutit Yunus Emre dhe Institucioneve tjera kontribuese në realizimin e projektit të përbashkët me Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

Mezar taşları, kültürün ve sanatın oluşum ve gelişim süreçleri hakkında bilgi verir. Yaşayan tarihin geçmişteki canlı örneklerinden kesitler sunar ve geçmişle bugün arasında bir köprü vazifesi görür. Mezar taşları, ortak tarihi en güzel yansıtan kitabelerdir. Ortak kültürün manevi yönlerine temas eder.

Kosova Cumhuriyeti İslam Birliği bünyesinde faaliyet gösteren İlahiyat Fakültesi Dekanlığı *"Priştine Yöresi Mezar Taşları Transkripsiyonu ve Çevirisi"* başlıklı çalışması ile başkent Priştine de bulunan Osmanlı Türkçesi ile yazılmış mezar taşlarını, Arnavutçaya ve Türkiye Türkçesine çevirerek dil, tarih, coğrafya, topografya gibi birçok bilimsel alan için önemli bir çalışma gerçekleştirmiştir. Takriben 1390'dan bu güne, ortak kültüre ait çeşitli eserleri içerisinde barındıran bu coğrafyada ortaya çıkarılan bu eserle hem günümüz insanlığına hem de yarınlarımıza ışık tutmada önemli bir rol üstlenecektir.

Bu mânâda, Yunus Emre Enstitüsü ve İslâm Birliği işbirliği ile tamamlanan bu çalışmaya emek sarf eden başta bilim adamları olmak üzere herkese, Enstitü personeline ve Kosova Kurumlarına teşekkür ederim.

RECENSION

Vështrimth epitafeve osmane
Mezar taşları hakkında bir kaç söz

Dr. Mustafa Küçük
Specialist i shkrimeve osmane pranë Arkivit Osman - Stamboll
Başbakanlık Osmanlı Arşivi Uzmanı - İstanbul

Vendbanimet që posedojnë varreza me mbishkrime janë dëshmi dokumentare për ekzistimin e popujve dhe kulturave në atë vend, në të njëjtën kohë çdo gurë varrezorë para se gjithash është një monument që përfaqëson një kulturë të një personaliteti të kohës. Veçantia e gurëve varrezor të periudhës osmane është se ata dallojnë njeri nga tjetri, përkatësisht duke filluar nga forma e gurit mund të kuptosh se i vdekuri vinte nga paria e dijetarëve, apo ishte nga ushtarakët. Dhe pikërisht këto informata me rëndësi për etërit tanë vinë përmes këtyre gurëve që në dukje duken shumë pasiv, por që në fakt ata në vete përmbajnë informata të gjalla për të kaluarën tonë. Prof. Beşir Ayvazoğlu në lidhje me rëndësinë e ruajtjes së këtyre dokumenteve të shkruara thotë: "Të lejosh zhdukjen e gurëve varrezorë është sikur të lejosh zhdukjen e regjistrimeve të popullatës, njëherit lejimi i një gjëje të tillë është barbarizmi më i madh që mund t'i bësh

Mezarlar, bulundukları şehirlerin temiz olup olmadıklarını gösteren aynalar olduğu gibi, bir beldenin nüfusunun kalıcı belgeleri, yani tapu senetleridirler. Her mezar taşı, ait olduğu kişinin yaşadığı toprağını gösteren bir âbidedir aynı zamanda. Sadece bu değil, mezar taşları aynı zamanda ölen kişiden bahsediliş şekliyle onun kültürünü, makam ve mevkii ile inancını da gösterir. Mezar taşının tepesinde yer alan kavuk veya sarık gibi işaretler, o mezarda yatan kişinin mensup olduğu askerî veya tarikat kimliğini, yahut hangi ulemâ sınıfına dâhil olduğunu bize bildirir. Elbette sadece bize değil; o milletin gelecek nesillerine de bu bilgileri ulaştıran aynı mezar taşlarıdır. Bu bakımdan Beşir Ayvazoğlu üstadın dediği gibi: "Mezarlıkları yok etmek, nüfus kayıtlarını silmek gibi müstevlîlere yaraşır bir barbarlıktır, soykırımdır".

Ne yazık ki bu barbarlığın sıkça icra edildiği bir ülkede yaşıyoruz. Yalnızca bizim ülkemizde değil; Osmanlı Devleti'nin son asrında ve yıkılışından sonra müstakil devlet olan Balkan ülkelerinin bir çoğunda

evliave (të dashurve të Allahut) dhe gjithë personaliteteve të ndjerë".

Fatkeqësisht po jetojmë në një botë ku po lejohet zhdukja e këtij inventari dokumentar të trashëguar nga paraardhësit tanë. Një gjë e tillë po ndodhë edhe nëpër qytetet e Kosovës, por përkundër kësaj, iniciativa për identifikimin, fotografimin dhe përkthimin e këtyre dokumenteve mbivarrezore, nga kolegët tanë profesionist të fushës, është një indikator që në të ardhmen të ruhet kjo pasuri kulturore e popullit.

Libri që keni në dorë përfshinë 10 vendbanime të regjionit të Prishtinës dhe jep informacione për personalitete të ndryshme që jetuan në këto treva gjatë periudhës së sundimit osman. Në këto mbishkrime, gjejmë emrat e të ndjerëve, baballarëve dhe nënave të tyre, sikur edhe emrat e zonjave dhe fëmijëve të tyre. Edhe pse në këto materiale monumentale të regjionit të Prishtinës nuk kemi hasur varreza të burokratëve dhe dijetarëve të njohur, janë gjetur shumë emra dhe profesione të ndryshme, si p.sh....

i meshiruari Ahmed Agaja,
i biri i Tatar Mustafasë
nga Novi Pazari,
Viti i vdekjes 1796.

Ashtu siç shihet në shembullin e lartcekur, këto mbishkrime në një mënyrë janë letërnjoftime të të parëve tanë, e që edhe shembulli i më poshtëm na jep informacion për prejardhjen e pronarit të varrit:

Nga muhaxhirët e Nishit,
I mëshiruari dhe i faluri
Mahmuti, i biri i Tahirit,
Për shpirtin e tij këndo Fâtihanë,
Viti 1321[Mars 1903].

da bu hazin manzaraya rastlamaktayız. Nitekim Kosova›da bazı cami hazirelerinin mezar taşlarının öteye beriye savrulduğunu birkaç kez tesbit etmiştik. Bununla birlikte ehl-i insaf ve mütehassıs bazı dostlarımızın, bu taşların kayda geçirilerek gereken düzen ve sıhhat üzere muhâfaza edilmeleri için gayret gösterdiklerine de şahit olmuşuzdur. İstifadenize sunulan bu eser de bunun açık bir delili ve güzel bir örneğidir.

Elinizdeki kitapta yer alan mezar taşları, Kosova'nın on bir bölgesinde yaşamış insanların yaklaşık yüz yıllık bir dönemini tanıtmaktadır. Onların adları, baba-koca adları, hanımlarının ve çocuklarının isimleri bu taşlarda kayıtlıdır. Eserde. devlet adamı ve ulemâ-meşâyih zümresinden bilinen isimlere rastlamamakla birlikte, pek çok meslek sahibi bu taşlarda zikredilmiştir:

El-merhûm eş-şehîd
Yeni Pazarlı Ahmed Ağa
ibn-i Tatar Mustafa
Sene 1211 [Temmuz 1796]

Görüldüğü gibi yukarıdaki mezar taşı âdetâ bir nüfus tezkiresi gibidir. Kezâ aşağıdaki örnek de, sahibinin eski vatanından izler taşımaktadır:

Niş muhâcirlerinden
El-merhûm el-mağfûr
Mahmûd bin Tâhir
Sene 1321 [Mart 1903]

Mezar taşlarının kitabelerinde en dikkat çekici ve ekseriya yer alan ibare, Allahu Teâlâ'nın yaratıcılığına dair olan ibarelerdir: *Huve›l-Hallâku›l-Bâkî (O, Bâkî olan Yaratıcıdır), El-Hallâku'l-Bâkî (Bâkî Yaratıcı).*

Bunun hâricinde, el-Hükmü li'llâh (Hüküm, Allah'ındır) ibaresi de sıkça kullanılır.

Kallëpi që më së shumti është përdorë në këto mbishkrimet monumentale pa dyshim që është: *Huve'l-Hal-lâku'l-Bâkî (Ai është Krijuesi dhe i Përjetshmi), El-Hal-lâku'l-Bâkî (Vetëm Allahu është i përjetshëm),* e cila dëshmon besimin në Njëshmërinë dhe Përjetësinë e Zotit.

Po ashtu, përmes përemrave vetor dhe prapashtesave; *ai* (huve); *ajo* (hije), dhe *mağfûr-etü, merhûm-etü* na është bërë me dije gjinia e pronarit të varrit dhe përkujtimi për të bërë lutje për shpirtrat e tyre. Me theks të veçantë, përmes fjalisë *el-muhtâc ilâ-Rabbihi'l-Gafûr* (i nevojshëm për falje nga ana e Allahut), në mënyrë direkte kërkohet një lutje nga ana e të gjallëve me qëllim të faljes së mëkateve të mundshme gjersa ishte në jetë. E nganjëherë, familjarët e të vdekurit nga dhimbja e humbjes së anëtarit të familjes, kërkojnë lutje të sinqerta nga vizitori për të vdekurin, duke i përkujtuar këtij të fundit (vizitorit) se edhe ti nesër do te jesh në gjendjen e njëjtë:

Nga vizitori kërkoj lutje.
Nëse sot me ka ndodhur mua,
nesër (të ndodh) ty.

Që konsiderojmë se është një referencë nga libri i shenjtë Kur'ani ***" Ti Vazhdo me këshillë, sepse këshilla besimtarëve u bën dobi".*** *(Dhârijât, 55),* po ashtu kemi edhe disa vargje që i janë kushtuar përkujtimit të jetës së përkohshme dhe vdekjes:

Ndaj kohë për ta vështruar
këtë gur të varrit,
nëse je i mençur mos u habit,
bëhu i logjikshëm,
(dje) isha i gjallë dhe

Ölen kişinin cinsiyetini belirten *huve* (o, erkek) veya *hiye* (o, kadın) zamirleri de belli bir nisbette kullanılmıştır.

Mağfûr, el-mağfûr; merhûm, el-merhûm gibi terimler kullanılarak, ölen kişinin hem cinsiyeti gösterilmekte, hem de onun adına Allahu Teâlâ'dan bağışlanma dilenmektedir. Zâten yine bu taşlarda yer elan el-muhtâc *ilâ-Rabbihi'l-Gafûr* (Rabbinin bağışlamasına muhtaç) ibaresi de bir nev'i kişinin dünya hayatında işlediklerinden dolayı Allah'tan bağışlanma talebidir ve yakınları bu sözlerle o duayı ebedî olarak arş-ı a'lâya yükseltmektedirler. Bazen de ölenin yakınları, hem ölüye rahmet okunmasını talep etmekte, hem de kendi yakınlarını kaybetmenin üzüntüsünü dile getirirken; kabristanı ziyarete gelenlere, kendilerinin de bir gün oraya; geçici ziyaret maksadıyla değil, kalıcı olarak geleceklerini hatırlatmaktadırlar:

Ziyâ*retten maksat bir duadır;*
*Bugün bana ise yarın s*anadır!

"Sen Müminlere anlat, çünkü bu onlara fayda verir" *(Zâriyât, 55)* âyet-i kerimesine işaret için olsa gerek, ölümü hatırlatma hususunda bazen birkaç beyitlik şiirlerin de bu taşlara hâkkedildiğini görüyoruz:

Dikkat ile nazar eyle,
Şu mezarın taşına.
Âkıl isen gâfil olma,
Aklını al başına.
Salınıp bütün gezerdim,
Neler gelir başıma.
Âkıbetler turâb olupdum,
Taş dikildi başıma.
El-merhûm el-magfûr
Recep Ağa bin Âdil Sipahi
Ruhûna Fâtiha
Sene 1310
[1892]

shih sot çfarë më ra në kokën time.
U bëra tokë me një gurë te koka.
I ndjeri, i faluri nga Zoti
Rexhep Aga,
i biri i Adil Sipahisë,
Për shpirtin e tij këndo Fâtihanë.
Viti 1310
[1892]

Mënyra e gdhendjes së shkronjave dhe përdorimit të stilit të shkrimit, njëherit edhe përmbajtja e teksteve mbi këta gurë varrezorë është e një rëndësie të veçantë edhe për kulturën e artit, letërsisë dhe mbi të gjitha për historinë e shkruar të këtyre personaliteteve.

Dünya hayatının fânîliği ile âhiret yurdunun bâkîliğinin de işlendiği mezar taşlarında, bu hakikatin lâfı hiç dolandırmadan dile getirilmesini; ölümün soğuk yüzünün, ebedî yurda varılma sevincine dönüştürülmesi şeklinde değerlendirmek mümkündür:

Kad intekale min-dâri'l-fânî ilâ dâri'l-bekā (Şüphesiz ki o geçici yurttan, ebedî yurda göçtü).

İnsanların dünya hayatını tercih edip üstün tutmalarına mukabil (A'lâ, 16), âhiret hayatının daha hayırlı ve sürekli olduğunu (A'lâ, 17) hatırlatan Hak Teâlâ'nın: ***"Elbette ki âhiret senin için dünyadan daha hayırlıdır."*** (Duhâ, 4) ikazlarının ne güzel yorumudur bu mezar taşı kitabesi.

Mezar taşlarının, gerek yazı tür ve güzellikleri, gerekse istif şekilleri cihetiyle hüsn-i hat örnekleri olarak taşıdıkları sanat değeri başka bir bahistir. Ama ne yazık ki bu kabîl örneklerin bir kısmı kırık-dökük, çok az bir kısmı kemal-i hüsn ile mevcutturlar. Bunların genellikle devlet ve tarikat ricali kabirlerinde yer aldığı ise cümlenin malûmudur.

Pamje nga Prishtina e vjetër - Xhamia Sulltan Mehmet Fatih (Xhamia e Madhe) dhe Sahat kulla
Eski Priştine manzarası - Fatih Sultan Mehmet Camisi ve Saat kulesi

REGJIONI I PRISHTINËS

1. Prishtina

Rajoni i Komunës së Prishtinës zë pozitën qendrore në Rrafshin e Kosovës. Përfshin territorin e Gallapit në lindje dhe një pjesë të fushës së Rrafshit të Kosovës. Në morfostrukturën e reliefit, territori i kësaj komune, në një pjesë e konsideruar, përfshin një territor kodrinoro-malor dhe territor fushor. Ky territor cilësohet me disa veçori lokale fiziko-gjeografike, të cilat paraqesin bazën natyrore për organizimin e zhvillimin e jetës dhe veprimtarive njerëzore.[1]

Gërmimet arkeologjike dhe gjetjet e rastit kanë dëshmuar se në mijëvjeçarin e gjashtë p.e.s., në Prishtinë dhe rrethinën e saj ngrihen vendbanime të përhershme, në afërsi të Spitalit, Matiçanit, Badocit, Glladnicës, Bardhit e gjetiu. Hulumtimet arkeologjike në Glladnicë kanë vënë në pah se popullata e neolitit është transformuar prej një popullate, e cila në periudhën paraprake është marrë kryesisht me gjueti dhe mbledhjen e fryteve në natyrë, në një popullatë që merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori, duke mos lënë anash zbukurimin e qeramikës dhe krijimin e veprave të rralla të artit dhe argjila e pjekur.[2]

Gjetje të konsideruara arkeologjike në territorin e Komunës së Prishtinës janë zbuluar edhe periudhave të epokës së bakrit, pastaj të bronzit, atë kalimtare prej bronzit në hekur. Në epokën e hekurit në trevën e Prishtinës janë ngritur një varg vendbanimesh në kodra dominuese, përgjatë rrugës antike Naissus-Lissus (Nish – Lezhë).

Lokaliteti i Prishtinës, duke u bazuar në gjetjet e ndryshme arkeologjike, mund të konstatohet se ishte i banuar që nga kohërat më të hershme. Këtë e dëshmojnë zbulimet arkeologjike që nga koha parahistorike e më vonë, në vendet si në Matiçan, te Tjerrtorja (vendbanim i vjetër dhe i madh i neolitit), Badoc, Bërnicë të Poshtme, Glladnicë, Bardhosh etj.

Ulpiana, si qendra kryesore urbane, administrative dhe tregtare në kohën antike në trevën e Kosovës, zhvillohet në vendin e kryqëzimit magjistral të rëndësisë primare në trevën e Evropës Juglindore. Pas rrënimit e pastaj rindërtimit nga ana e Justinianit dhe pagëzimit me emrin Justiniana Secunda, ky lokalitet vazhdoi të mbijetonte edhe një kohë, kur u shkatërrua nga tërmeti. Mirëpo, në afërsi të tij ngrihet lokaliteti i ri (sipas

1 Më gjërësisht për historikun e Prishtinës, shih: Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtina, Kastrioti (Obiliqi) dhe Fushë Kosova, Prishtinë, 2003, fq. 175-199.

2 Haxhi Mehmetaj, Nga Iashtësia e Prishtinës. Dorëshkrim që ruhet në Arkivin e Qytetit të Prishtinës, në dokumentet e ekspozitës: Prishtina, dikur dhe sot.

të gjitha gjasave, nga ndonjë vendbanim satelitor), Prishtina e sotme, e cila i merr të gjitha funksionet urbane të Ulpianës së dikurshme. Përkitazi me emrin Prishtina ekzistojnë disa mendime. Megjithatë, mendimi më i kapshëm është ai, i cili thotë se emri Prishtina duhet ta ketë prejardhjen nga Pri - istina, që i përket në Istrianu-Justiniana ose etimologjia e fjalës duhet të rrjedhë nga ndonjë gjuhë e lashtë indoevropiane: ilirishtja ose trakishtja.

Në lokalitetin e këtij vendbanimi janë gjetur disa mbishkrime latine të periudhës ilirodardane, të kohës së sundimit romak.

Për Prishtinën ka të dhëna edhe më të hershme, por ajo përmendet si Trullishtë gjatë kohës së Stefan Nemanjës[3]. Prishtina si vendbanim përmendet në shek. XIII si "fshat", kurse në kartën e kishës së Shën Stefanit, më 1315-1318, përmendet "rruga e Prishtinës". Prishtina zihet në gojë edhe në vitin 1325, me ç'rast mbreti Stefan Deçani kërkoi nga raguzanët që tributin e Shën Dhimitrit t'ia sillnin në Prishtinë[4]. Ndërkaq, në vitin 1342, perandori bizantin, Jan Kantakuzeni, i cili në këtë vit gjeti strehim te mbreti Dushan, jep përshkrimin e Prishtinës. Sipas perandorit, Prishtina (Pristinon) ishte një fshat i pafortifikuar, ku vetëm oborri mbretëror kishte një vlerë të posaçme[5].

Prishtina në kuadrin e shtetit të Nemanjidasve, permendet si qendër ku shpesh rrinin mbreti Millutin, e më vonë perandori Dushan, e pastaj ajo bëhet njëra ndër qendrat më të njohura të Vuk Brankoviqit.[6]

Në mars të vitit 1365, perandori Urosh në Prishtinë lëshoi kartën e vet, me të cilën miratoi aktin e faljes në dobi të manastirit të Hilandarit. Para vitit 1387, në Prishtinë ekzistonte kisha katolike e Shën Mërisë[7].

Zhvillimi i tregtisë dhe i xehetarisë gjatë mesjetës ndikoi edhe në përparimin dhe rritjen e qytetit. Prishtina si qendër ekonomike dhe tregtare e ka pasur edhe tregun e vet – "piazza de Pristina", i cili ishte në qendër të qytetit. Në deceniet e para të shekullit XV, në burimet e shumta shënohet për Prishtinën "se është një shesh i pasur dhe i bukur të cilin e vizitojnë shumë tregtarë nga të gjitha vendet e jashtme.

Të dhëna të hollsishme mbi pushtimin osman të Prishtinës nuk dimë. Në shkencë dominon mendimi se atëherë kur u pushtuan Novoberda, Trepça dhe Janjeva, pas gjithë gjasash, u pushtua edhe Prishtina. Gjithsesi ky pushtim duhet të ketë ngjarë në vitin 1455.[8]

Pas rënies definitive nën pushtetin osman, në gjysmën e dytë të shek. XV, Prishtina edhe më tutje mbante rolin udhëheqës tregtar dhe administrativ. Sipas dëfterit osman të vitit 1477, shihet se Prishtina në atë vit kishte 9 lagje me 351 shtëpi. Në dëfterin

3 Zadužbine Kosova, Beograd – Prizren, 1977, fq. 512-513.

4 Dr. Jahja Drançolli, Raguzanët në Kosovë (prej fundit të shekullit XIII deri në vitin 1455), Prishtinë, 1986, fq.122.

5 K. Jeriček - J. Radonic, Istorija Srba II, Beograd, 1952, fq. 21, 94, 230; Dr. J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë, fq. 122.

6 K. Jericek, Istorija Srba I, Beograd, 1952, fq. 244, 271, 305, 346, II. 352-353.

7 Historijski Arhiv Dubrovnik, Testamenta Notariae IV, f.121v; D. Kovačević - Kojić, "Priština u srednjem veku", Istorijski časopis, Beograd, 1975/XXII, fq.46; Dr. Jahja Drançolli, Raguzanët në Kosovë, Prishtinë, 1986, fq. 123; Dr. Jahja Drançolli, Lojërat kalorësiake në Prishtinë në shek. XV, Rilindja, 8.XII.1984.

8 Muhamet Tërrnava, Popullsia e Prishtinës në gjysmën e dytë të shekullit XVI, Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979, fq. 109;

tjetër të vitit 1486/87, si has i Sanxhakut të Vushtrrisë dalin edhe 51 shtëpi më tepër, të cilat janë të besimit islam, kurse në mëhallën jomyslimane: 248 shtëpi "hane" (me kryefamiljar burrin), 34 shtëpi "mucerret" (me kryefamiljar beqarin), 56 shtëpi "bive" (me kryefamiljar vejushën) dhe 3 bashtina dhe kishte naihinë prej 51 fshatrave.[9]

Feliks Petançiqi, diplomat dubrovnikas dhe deputet në Oborrin Mbretëror të Hungarisë, më 1502, e përshkruan fushën e Kosovës si vend me fshatra të vogla dhe të shpërndara. Ai në shënimet e tij përmend se "aty në periferi gjendet Prishtina, vendbanim shumë i pasur"[10]. Ndërsa, Haxhi Kallfa në shek. XVII kështu e përshkruan Prishtinën, në kuadrin e Sanxhakut të Vushtrrisë: ''Prishtina, qytezë e mesme, e rrethuar me male, 18 ditë rruga nga Stambolli, në mes të Novobërdës dhe Vushtrrisë. Meqenëse Kosova është në këtë trevë, këtu banon kujdestari i xeheve. Gjendet dy ditë rrugë në veriperëndim të Shkupit".[11] Më 8/1527 Prishtina ishte has i sulltanit me të ardhura vjetore prej 59.551 akçesh.

Nga kjo anë përmenden edhe dijetarë të dëgjuar. Kështu përmendet Mesihi nga Prishtina, që njihet me veprën e tij poetike ''Mesihi Divani" (Libri i vjershave të Mesihit). Kjo vepër, e shkruar në turqishte, ka vlerë të madhe letrare dhe historike. Mesihi është, pa dyshim, njëri nga poetët e parë shqiptarë, i cili vdiq në vitin 1512 në Bosnjë.

Prishtina merr një fizionomi tjetër në periudhën e sundimit osman. Ajo ka pasur shumë elemente të arkitekturës orientale, me rrugë të ngushta të shtruara me kalldrëm, hamame, me çarshi të mbyllur dhe dyqane. Ndërtohen disa monumente me vlerë kulturo-historike, si xhamia e mbretit (Fatih), e ngritur në vitin 1461 nga sulltani turk, Mehmed Fatihu II, pastaj Kulla e Sahatit, Xhamia e Çarshisë etj. Prishtina, nga mbarimi i shekullit XVI, ishte qendër e rëndësishme politike, ekonomike dhe administrative e Perandorisë Osmane.

Në fund të shekullit XVI Prishtina ka qenë qendër e rëndësishme politike, ekonomike dhe administrative e Perandorisë Osmane. Turqit atëherë kanë mbajtur edhe dogana, kanë pasur gjyqe dhe institucione të tjera shtetërore e kulturore. Në këtë periudhë, në qendër të qytetit, janë ndërtuar godina të rëndësishme për organet shtetërore dhe të administratës.

Se çfarë panorame kishte Prishtina në gjashtëdhjetëshin e shek. XVII më së miri na e tregon Evilija Qelebiu (1662), i cili thotë: "Prishtina, është emër latin. Kalanë e Prishtinës e ka ndërtuar mbreti serb. Atë e pushtoi Sulltan Murati I, të cilën e rrënoi. Prishtina është një kaza e gradës 150 akçesh. Kadiu i saj prej nahijes së Prishtinës merrte 5 kese (1 kese=50.000 akçe) të ardhura në vit. Aty është Selia e Qehasë,[12] dhe e komandantit (serdar) të jeniçerëve. Ka ajan dhe eshraf (fisnik). Ka 2.060 shtëpi një dhe dykatëshe të punuara me gurë dhe me pullaze. Nga shtëpitë

9 Adem Handzić, Nekoliko vijesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV vijeka, Simpozij për Skëndërbeun, Prishtinë, 1969, fq. 208-209; Muhamet Tërrnava, Popullsia e Prishtinës në gjysmën e dytë të shekullit XVI, Onomastika e Kosovës, v. e c. fq. 110.

10 Rad Jugoslovenske akademije znanosti i umjetnosti, lib. 49, fq. 134.

11 Hadzi Kalfa ili Čatib-Čelebija, Turski geograf XVII veka, O Balkanskom Poluostrvu, S. Novaković, Spomenik XVII, Beograd, 1892, fq. 58.

12 Qehaja, kujdestari i pasuriës së një begu ose të një pronari; qehaja i esnafit, ai që përfaqësonte një esnaf të marrëdhëniet e ndryshme me të tjerët.

e mëdha përmendet Saraji i Allajbeut (kolonelit) dhe Pallati i Gjyqit. Këtu janë 11 hane tregtarësh. Brenda çarshisë është Hamami i Sulltan Mehmet Pushtuesit. Brenda në çarshi ndodhet gjithashtu hamami i vjetër, godina e të cilit është shumë e bukur dhe tërheqëse. Në qytet gjenden 300 dyqane, të cilat, në krahasim me madhësinë e qytetit, janë të pakta. Vreshtat dhe bahçet janë të shumta, veçmas rrushi e dardhat janë në zë. Fisnikët dhe familjet më të mira këtu kanë kënaqësinë t'i pranojnë mysafirët – të pasur dhe të varfër, të rinj e të moshuar, të cilët i presin me krah hapur. Për shkak të klimës së mirë, këtu njeriu mund të shohë djem e vajza, të cilët me bukurinë e tyre janë bërë të famshëm anembanë trojeve osmane".

Në pjesën e dytë të shek. XVII, sipas disa burimeve, Prishtina ishte ndër qytetet kryesore të Kosovës. Ndërkaq, në shekullin XVIII, Prishtina nuk ishte ndonjë qytet shumë i rëndësishëm. Duke filluar nga shekulli XIX, Prishtina fillon përsëri të rimëkëmbet si qytet me ekonomi të zhvilluar, ku mbahen edhe panairet. Sipas raportit të nënkonsullit francez në Prishtinë, Antun-Lui Vas, i cili qëndroi një kohë të shkurtër në Prishtinë, në vitin 1812, pos tjerash, për Prishtinën shkruan: Prishtina ishte vendi më i rëndësishëm, ngase këtu kryqëzoheshin udhët nga Selaniku e Stambolli dhe këtu do të ishte depoja e tregtisë. [13]

Shtëpitë në Prishtinë, sipas udhëpërshkruesit Ami Bue (1830), ishin përdhese, rrugët e gjera me trotuare të ngushta. Nga objektet më të mëdha përmendet Sahat-Kulla dhe 12 xhami, sidomos theksohet çarshia e mbuluar. Çarshia, edhe më tutje, zinte pjesën qendrore të qytetit.

Udhëpërshkruesi gjerman, J. Muler (1838), shkruan se Prishtina kishte 1.800 shtëpi me 10.000 banorë[14]. Në atë kohë (1857) Prishtina, siç na informon A. F. Gilferding, kishte 1.500 shtëpi: 1200 shtëpi myslimane (kryesisht shqiptarë të kësaj feje) dhe 300 shtëpi ortodokse (kryesisht serbë e vlleh). Pastaj, ky bashkëkohës thotë se Prishtina i kishte shtëpitë e vogla, të ndërtuara me qerpiç. Rrugët i kishte të ngushta e të shtruara me kalldrëm. Çarshia përbëhej nga shtëpitë e dyqanet. Prishtina dallohej me dhjetëra xhami të ngritura nga mermeri i bardhë. Në Prishtinë administronte një mydyr i zakonshëm, i cili ishte nën administrimin e pashait të Prizrenit.[15] Sipas shënimeve zyrtare statistikore të Perandorisë Osmane të shpallura edhe në gazetën ''La Turqie", Kazaja e Prishtinës, në kuadrin e Vilajetit të Prizrenit, në vitin 1871 i kishte 258 fshatra me 13.430 banorë myslimanë dhe 5.825 banorë jomyslimanë.[16]

Prej vitit 1864 në Prishtinë vendosen edhe disa familje çerkeze. Duhet theksuar se në Prishtinë, pas dëbimit të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, më 1877/78, këtu u vendosën më tepër se 500 familje muhaxhire shqiptare, të cilat në Prishtinë e formuan edhe Lagjen e Muhaxhirëve. Edhe Lagjja Qeklik është krijuar në vitin 1878 nga vendosja e romëve myslimanë të shpërngulur nga Sanxhaku i Nishit[17].

---

13 Arkivi Shtetëror i Kosovës, Dokumentet e hulumtuara në Arkivin Kombëtar të Francës në Paris, Fondi: Ministria e Punëve të Jashtme, viti 1812; A. Urosevic, Prishtina, antropogeografska ispitivanja, Beograd, 1951, fq. 9.

14 Bedrush Shehu, Një raport i J. Mullerit për Kosovën në vitin 1838, ''Kosova", nr. 5, Prishtnë, 1976, fq. 67-68.

15 A. F. Gilferding, Putovanje po Hercegovini, Bosni i Staroj Srbiji, Sarajevo, 1972, fq. 214-215.

16 Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtina, . . . , v. e c., fq. 186.

17 E njëjtë, fq. 186.

Në këtë kohë në qytetin e Prishtinës kishte 17 xhami të mëdha dhe të vogla, një teqe, një kishë, një sinagogë, një sahat-kullë, 14 hane, 16 mejhane, 525 dyqane, një treg të mbuluar – çarshi të mbuluar (bedistan) me 28 dyqane dhe tri hamame.[18]

Me riorganizimin administrativ të Perandorisë Osmane, dhe supriminim e Vilajetit të Prizrenit, themelohet Vilajeti i Kosovës, i cili, përveç territorit të sotëm të Kosovës, ka përfshirë edhe Sanxhakun e atëhershëm të Jeni Pazarit. Seli e atij Vilajeti në vitin 1877 bëhet Prishtina. Në vitin 1888, pas lidhjes së hekurudhës së Vardarit me atë të Moravës, selia e Vilajetit kalon në Shkup si nyjë hekurudhore. Prishtina në kuadrin e atij Vilajeti, mbetet si qendër e sanxhakut.

Në Sallnamen turke të vitit 1896 thuhet se Prishtina kishte 3 xhami të mëdha dhe 10 xhami të vogla me minare si dhe 5-6 mesxhide (xhami pa minaret). Ekzistonte edhe një medrese. Prishtina kishte 3.690 ndërtesa. Prej tyre 500 ishin dyqane dhe magazina, 2 hotele, 10 hane, 1 sahat-kullë, 1 konak shtetëror, një kanalizim prej 400 metrash, një hamam për meshkuj e femra (i mbetur nga kohërat e vjetra), 2 hamame të mëdhenj vetëm për meshkuj, 1 spital, 1 magazinë armësh, 1 depo, 1 barakë të madhe për kafshë të artilerisë, 1 zyrë të komunës (belediye). Në Prishtinë ekzistonte Banka Bujqësore. Këtu prodhohej një lloj sapuni i quajtur misk.[19]

Sipas sallnames turke të vitit 1900 Prishtina kishte 13 lagje me 3690 shtëpi (Kazaja e Prishtinës ka 248 fshatra me 8027 shtëpi). Në Prishtinë ka pasur 18.223 banorë myslimanë (9088 meshkuj, 8685 femra), 1962 banorë të krishterë (989 meshkuj, 973 femra), romë myslimanë 660 banorë (350 meshkuj, 310 femra), romë të krishterë 383 banorë (198 meshkuj, 185 femra), hebrenj 361 banorë (178 meshkuj, 183 femra). Gjithsej 21.206 banorë (9588 meshkuj dhe 8635 femra). Në këtë sallname thuhet se Prishtina ka mbi 500 dyqane dhe depo, 2 hotele, 10 hane-bujtina, një sahat-kullë, një ndërtesë pushteti 400 me gjatë, 3 biblioteka për lexim, dy banja publike (një për femra e tjetra për meshkuj), një spital, një xhephane për monedha, 3 xhami të mëdha me minare, 10 faltore të vogla me minare, 5 pa minare, sahat-kulla me orë dhe 3 orë tjera alarmuese, një mysafirhane - selamllën, fabrikën e miellit, konakun e pushtetit, një depo për armë, roja e kufijve me Serbinë, 16 karakollë ushtarakë etj. Në këtë sallname thuhet se në Gërmi ishte nxjerrë lënda për oxhaqe. Popullsia kryesisht është marrë me zejtari, bujqësi, kopshtari etj.[20]

Për Prishtinën shkruan edhe Sami Frashëri, i cili thotë: Prishtina ishte kasaba, e cila gjendet në verilindje të Arnautllukut, qendër sanxhaku, ku kishte objekte me rëndësi historike, kulturore dhe tregtare. Gjendet nja 10 km larg në lidhje të hekurudhës Selanik-Mitrovicë. Kishte pozitë të bukur. Kishte 10.638 banorë, nga të cilët 8.156 ishin të besimit mysliman, kurse të tjerët ishin me kombësi të ndryshme. Edhe pse e tërë popullsia është me kombësi shqiptare, në kasaba turqishtja përdoret me të madhe. Në Prishtinë ishin 13 xhami, 5 mesxhide, 2 medrese, 1 ruzhdije, 2 iptidaije, 1 për meshkuj e 1 për femra, disa sibjanmektebe (shkolla fillore-foshnjore), 3 bujtina publike dhe 1 spital ushtarak që ndodhej jashtë qyteti. Aty ndodheshin edhe 500

18 Hasan Kaleshi – Hans-Jurgen, Prizrenski Vilajet ''Përparimi'' (Izbor radova na srpskohrvatskom jeziku), 1, Prishtinë, 1967, fq. 94.
19 Kosova Vilayeti Salnamesi, 1896 (1314 h), Uskup, Priştine, Prizren, Ipek, Yenipazar, Taslica, Stanboll, 2000, fq. 185.
20 Arkivi i Kosovës, Sallname e Vilajetit të Kosovës e vitit 1900 (1318).

depo dhe dyqane, 10 bujtina dhe 2 mysafirhane. Në kasaba prodhohej njëfarë lloj sapuni me erë shumë të këndshme…[21]

Në fund të vitit 1912 Prishtina u pushtua nga serbët. Për shkak të dhunës, terrorit, vrasjeve, përndjekjeve, shumë familje shqiptare, por edhe turke, e sidomos ato feudale, intelektuale e të tjera u detyruan të shpërnguleshin kryesisht në Turqi. Është një numër i madh i të shpërngulurve, prandaj vështirë se mund të dihet numri i saktë. Mirëpo, lagje të tëra janë shpërngulur. Thuhet se çarshia e dikurshme e Prishtinës e humbi pamjen që e kishte, zejtarët kryesorë u shpërngulën. Në vend të tyre, Prishtina filloi të kolonizohej me elementin sllav që vinin si pushtetarë, nëpunës, xhandarë, ushtarakë, mësues dhe të tjerë. Kështu Prishtina e ndërroi pamjen e vet. Lufta e Parë Botërore ndikoi shumë në shkatërrimin e Prishtinës dhe në tërësi të Kosovës, sidomos pjesa që ishte nën sundimin bullgar. Në vitin 1915 Prishtinën e kishte përfshirë epidemia e tifos së morrit. Në vitin 1917 Prishtinën, sikurse në përgjithësi Kosovën, e përfshiu zija e bukës.[22]

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore, Kosova u ripushtua prapë nga pushteti serbo-malazez. Presionet, përndjekjet, shtypjet, vrasjet etj., jo vetëm që vazhduan, por u shtuan në masë të madhe. Filloi vala e re e shpërnguljes së popullatës shqiptare, diçka edhe të asaj turke, për në Turqi, Shqipëri e gjetiu. Kjo shpërngulje vazhdoi gjatë tërë sundimit të Mbretërisë Jugosllave.

Në bazë të shënimeve statistikore që kemi, Prishtina, në vitin 1927, kishte 3.025 shtëpi me 15.080 banorë (9.534 shqiptarë, 4.483 serbë, 350 të tjerë). Ndërsa, në vitin 1931 Prishtina kishte 16.358 banorë.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore u ndërpre vala e kolonizimit të Kosovës me elementin sllav, sikurse dhe shpërngulja e popullatës shqiptare në Turqi, në Shqipëri e gjetiu. Pas ndarjes së Kosovës nga shtetet centraliste, Prishtina, në fillim, i takoi zonës italiane, ndërsa pas kapitullimit të Italisë fashiste, këtu qeveriste Gjermania. Banorët e Prishtinës dhe të rrethinës, sikurse edhe të tjerët, morën pjesë në çlirimin e vendit në anën e koalicionit antifashist. Kështu, Prishtina u "çlirua" më 19 nëntor 1944, por prapë mbeti në kuadrin Jugosllavisë.

Prishtina, në vitet e para pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, përjetoi disa rrënime nga sunduesit e rinj. U rrënua pjesa më e vjetër e qytetit, çarshia e mbuluar, konakët e njohur, hanet, hamamet, xhamia në qendër të qytetit, kisha katolike, ujësjellësi dhe krojet, që ishin në të gjitha rrugët. E gjithë kjo është bërë me parullën demagogjike, por me qëllim të caktuar: "Prishim të vjetrat dhe ndërtojmë të rejat".

Përkundër kësaj, dinamika e zhvillimit të Prishtinës drejt tipareve të një metropoli rajonal nis me fitimin prej saj të funksioneve të qendrës administrative të Kosovës (1947). Prishtina filloi të bëhej qendër e rëndësishme politike dhe administrative. Ajo mori statusin e qytetit dhe u formua Këshilli Popullor i Qytetit të Prishtinës. Të gjitha këto ndikuan që Prishtina, si kryeqytet i Kosovës, të bëhet qendër e rëndësishme politike,

21 Sami Frashëri, Vepra 7, "Rilindja", Prishtinë, 1984, fq. 475-476.

22 Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtina, Kastrioti dhe Fushë Kosova, Prishtinë, 2003.

administrative, ekonomike, kulturore, arsimore, shkencore dhe sportive në tërë territorin e Kosovës. Kështu, nga 16.000 banorë sa kishte Prishtina në vitin 1937, përkatësisht 19.600 banorë në vitin 1948, në vitin 1981 arriti në 108.000 banorë.

Zhvillimi i këtillë demografik ishte pasojë e zhvillimit ekonomik dhe, përgjithësisht, e zhvillimit shoqëror-ekonomik, i cili Prishtinën, nga një qytet i vogël dhe i vjetruar, e shndërroi në qytet bashkëkohor.

Prishtina përjetoi një transformim të vërtetë duke filluar nga fundi i dekadës së gjashtë dhe në dekadën e shtatë të shek. XX, në aspektin ekonomik, kulturor, arsimor, shëndetësor etj. Kjo u arrit në saje të ndryshimeve politiko-shoqërore në Jugosllavinë Socialiste, kur Kosova fitoi elementin konstituiv në federatën Jugosllave dhe ndryshoi edhe pozita e saj.

Sikurse edhe vendbanimet e tjera, edhe Prishtina, gjatë sulmeve të agresorit serb në vitet 1998-1999 pësoi mjaft, sidomos në njerëz. Janë vrarë edhe një numër i konsideruar i personave, të cilët ishin strehuar gjatë luftës së fundit në Prishtinë. Nga pasojat e luftës e sulmeve ajrore kanë pësuar edhe disa banorë të Prishtinës. Janë shkatërruar dhe janë djegur edhe disa shtëpi private, sidomos në lagjen Kodra e Trimave, pastaj janë djegur e shkatërruar edhe disa dyqane dhe kioska. Më 13 qershor 1999 është djegur Selia e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës me tërë dokumentacionin arkivor disashekullor. Më 27 mars 1999 është djegur përbrenda xhamia "Ramadanie" e quajtur Xhamia e Llapit, e ndërtuar në vitin 1470. Është plaçkitur në masë të madhe popullata dhe lokalet.

Pas mbarimit të luftës, popullata e ikur nga Prishtina u kthye. Filloi themelimi i organeve të pushtetit dhe rindërtimi i Prishtinës. Sot Prishtina, si kryeqyteti i Kosovës, është shndërruar në një metropol rajonal, qendër politike, administrative, kulturore, arsimore, universitare, ekonomike etj.

Në territorin e Prishtinës, deri me tani janë zbuluar 57 epitafe në gjuhën osmane:

Vendi i origjinës

Prishtinë

Viti sipas kalendarit gregorian

1522

Gjendja momentale

E mirë

Varri nr. 1.1

Kitabeja në origjinal:

هو
المرحوم المغفور
سيف الله بن خالد
روحنه فاتحه
٩٢٨ سنه

Kitabeja e transkriptuar:

Huve
El-merhûm el-mağfûr
Seyfullah bin Hâlid
Rûhuna Fâtiha
Sene 928

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu)!
I mëshiruari dhe i faluri
(nga Zoti),
Sejfullahu, i biri i Halidit.
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë.
Viti 928

Vendi i origjinës
Varrezat e Prishtinës
Viti sipas kalendarit gregorian
1796
Gjendja momentale
I dëmtuar

Varri nr. 1.2

Kitabeja ne original:

ذياردتن مراد
دياردعادر
بوكون بكا ايسه
يارين سكادر
المرحوم الشهيد
يكى پازارلي احمد آغا
ابن تاتارمصطفي
لسنة ١٢١١

Kitabeja e transkriptuar:

Ziyâretden murâd
Diyâr duâdır
Bugün bana ise
Yarın sanadır
El-merhûm eş-şehîd
Yeni Pazarlı Ahmed Ağa
ibn-i Tatar Mustafa
li-Sene 1211

Përkthimi në gjuhën shqipe::

Nga vizitori kërkoj lutje:
Nëse sot më ka ndodhur
mua, nesër (të ndodhë) ty.
I mëshiruari Shehid ...
nga Jeni Pazari,
Ahmed Agaja
i biri i Tatar Mustafasë.
Viti 1211

Vendi I origjinës

Prishtinë

Viti sipas kalendarit gregorian

1826

Gjendja momentale

E mirë

Varri nr. 1.3

Kitabeja ne original:

الحكم لله
مرحومة جزيده
بنت رجب
روحنه فاتحه
سنه ١٢٤٢

Kitabeja e transkriptuar:

El-hükmü li'llâh
Merhûme Cezîde
bint-i Receb
Rûhuna Fâtiha
Sene 1242

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Gjykimi i takon vetëm
Allahut!
E mëshiruara Xhezideja,
e bija e Rexhepit.
Për shpirtin e saj këndo
Fâtihanë.
Viti 1242

Vendi i origjinës
Prishtinë
Viti sipas kalendarit gregorian
1827
Gjendja momentale
E mirë

Varri nr. 1.4

Kitabeja në origjinal:

هوالباقي
المرحومة والمغفورة
زينب بنت مصطفى
روحنه الفاتحه
سنه ١٢٤٣

Kitabeja e transkriptuar:

Huve'l-Bâkî
El-merhûme ve el-mağfûre
Zeyneb bint-i Mustafa
Rûhuna el-Fâtiha
Sene 1243

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu) është i
Përhershëm!
E mëshiruara dhe e falura
Zejnebeja, e bija e
Mustafasë.
Për shpirtin e saj këndo
Fâtihanë.
Viti 1243

Vendi i origjinës

Prishtinë

Viti sipas kalendarit gregorian

1837

Gjendja momentale

E dëmtuar

Varri nr. 1.5

Kitabeja në origjinal:

المرحوم المغفور
المحتاج الي
ربه ا لغفور
حسين بن قورتش
روحنه
الفاتحه سنه ١٢٥٣

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm el-mağfûr
El-muhtâc ilâ
Rabbihi'l-Gafûr
Hüseyin bin Kurtiş
Rûhuna
El-Fâtiha
Sene 1253

Përkthimi në gjuhën shqipe:

I mëshiruari, i faluri,
nevojtar për
Krijuesin e tij Shumëfalës,
Hysejni, i biri i Kurtishit.
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë.
Viti 1253

Vendi i origjinës
Prishtinë
Viti sipas kalendarit gregorian
1879
Gjendja momentale
E mirë

Varri nr. 1.6

Kitabeja në origjinal:

هوالخلاق الباقى
المرحوم المغفور
الحاج محمد بن احمد
روحنه فاتحه
سنه ١٢٩٦

Kitabeja e transkriptuar:

Huve'l-Hallâku'l-Bâkî
El-merhûm el-mağfûr
El-Hâc Mehmed
bin Ahmed
Rûhuna Fâtiha
Sene 1296

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu) është Krijuesi i
Përhershëm!
Në një dokument të datës 30 nëntor 1584 për Janjevën thuhet se është vend i pasur me miniera ari dhe argjendi.....[10] Sipas relacionit të argjipeshkvit të Tivarit, Marin Bici, drejtuar papa Palit V më 1610, Janjeva ishte vendosur midis disa kodrinave të zgavruara prej minierave të argjendit, nga të cilat nxirrej aty me sasi të madhe. Ky qytet kishte 120 shtëpi "latine", 200 shtëpi "skizmatikësh" dhe 120 shtëpi turke (shqiptare). Ndërsa, në shek. XVII, përkatësisht në vitin 1637, sipas Gjergj Bardhit, kishte 680 frymë katolikësh.[11] Po ai, më 1642, raporton se Janjeva kishte 85 shtëpi katolike, 120 shtëpi turke (shqiptare – myslimane, J. O.) dhe 180 shtëpi ortodokse[12], d.m.th. gjithsej 385 shtëpi.

Janjeva përmendet në shumë dokumente kishtare, letra të misionarëve katolikë etj., të periudhave të ndryshme kohore, e sidomos në shek. XVII. Po e theksojmë një letër të dërguar nga Shkupi më 28 janar 1679, ku, në mes tjerash, thuhet: Për shkak të nisjes së dy priftërnjëve, don Andrea Pashtroviqit dhe don Vinçens Mateviqit, njëri nga Shkupi e tjetri nga Janjeva, kisha metropolite mbetet pa famullitar dhe Janjeva pa mësues shkolle. Prandaj, Pjetër Bogdani kërkon që nipi i tij, Gjoni, të mund të vijë për ta ndihmuar në Janjevë (Kosovë). Ky i fundit do të jetë edhe misionar për t'i përmbushur nevojat shpirtërore të këtyre njerëzve, ngase është mjaft i aftë për këtë detyrë.[13] Në dokumentin tjetër të vitit 1680, thuhet se: argjipeshkvi i Shkupit e cakton Gjon Bogdanin mësues në Janjevë, i cili e filloi punën më 6 janar.[14]

Në hartën austriake të vitit 1689, Janjeva është regjistruar si vendbanim mjaft i madh.

Në letrën për vizitën kanonike të Argjipeshkvisë së Shkupit, të vitit 1725, argjipeshkëv Karagiqi shkruan: "Në qytetin e Janjevës misionar apostolik është don Mikel Summa. Në vetë qytetin ka 11 shtëpi të besimtarëve të krishterë me 80 anëtarë..."[15] Argjipeshkvi Matej Mazreku, në letrën e vitit 1760, thotë se ka ikur për Janjevë, seli e Argjipeshkvisë dhe vendlindje e tij. Janjeva ishte një vend i pasur me xehe, në të cilin më parë kishte

7 Ilijaz Rexha, Regjistri i vendbanimeve dhe i popullsisë së Kazasë së Novobërdës sipas Defterit Kadastral nr. 28, Vjetari i Arkivit të Kosovës, XXVII-XXVIII, Prishtinë, 2002.

8 Selami Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI, Tiranë, 1984, fq. 702.

9 Skender Rizaj, Kosova gjatë shek. XV, XVI dhe XVII, Prishtinë, 1982, fq. 211.

10 Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë, ASH e RPS të Shqipërisë, Instituti i hsitorisë, I, Tiranë, 1989, fq.37; Biblioteka Apost. Vatikane, Vat. lat 6533.

11 Ignjac Zamputi, Relacione I, 473, fq. 451.

12 E njëjtë.

13 Odette Marquet, Pjetër Bogdani, Letra dhe dorëshkrime, nga Arkivi i Kongregatës "de Propagand Fide" si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit, Shkodër, 1997, fq. 218.

14 E njëjtë

15 ASV.S. congr. Concili, Scopien, Relativ 1725, v. 728; Frok Zefi, Arqipeshkvnija Shkup-Prizren në shekullin XVIII-të, Osjek, 2000, fq. 131.

shumë besimtarë të krishterë, por gjatë luftërave disa janë shpërngulur, disa janë vrarë dhe disa të tjerë janë shitur si skllevër.[16]

Përveç kishës, e cila është rindërtuar më vonë, me rëndësi është edhe xhamia e Janjevës, e cila është ndërtuar nga koha e Sulltan Mehmet Fatihut (1451-1481).

Në aspektin administrativ, Janjeva ishte kadillëk. Në gjysmën e shek. XVII gjeografi turk Haxhi Kallfa e përmend Sanxhakun Vushtrrisë në kuadrin e Elajetit të Rumelisë. Sanxhaku ishte ndarë në 6 kaza: Vushtrria, Prishtina, Kosova, Janjeva, Morava dhe Novobërda. Në një tapi të gjetur në fshatin Akllap të vitit 1749, të nënshkruar nga Jakup Emin Janjeva, si duket, kadi që punonte në Janjevë. Gjatë sundimit të familjes Gjinolli në Gjilan, kjo trevë ishte e përfshirë në kuadër të sundimit të tyre, përkatësisht të mudirit të Gjilanit. Mirëpo, pas rënies së tyre kthehet nën administrimin e Sanxhakut të Prishtinës.[17]

Nga aspekti ekonomik, Janjeva deri në shek. XVII ishte qendër e njohur xehetarie. Xehetaria ishte dega kryesore e ekonomisë dhe profesioni kryesor i popullsisë së kësaj treve. Përveç xehetarisë edhe tregtia ishte mjaft e zhvilluar, ku këtu përmenden tregtarët dubrovnikas në shek. XV, por edhe më herët. Janjeva me ekonominë e saj xehetare filloi të bjerë që nga gjysma e shekullit XVII, por rënia e saj e madhe daton nga fundi i shekullit XVIII. Me rënien e xehetarisë e tregtisë, popullata e saj pjesërisht u shpërngul, ndërsa ajo pjesë që mbeti iu përshtat kushteve të reja. Ajo filloi të merret me zejtari, me shkrirjen dhe me përpunimin e metaleve, punimin e veglave, enëve, artizanateve etj. nga argjendi, ari etj. Më vonë, deri në ditët e sotme edhe nga plastika. Janjeva e kishte edhe çarshinë e vet. Ky vendbanin shndërrohet në një qendër të njohur zejtare, jo vetëm në Kosovë por edhe në Ballkan.

Sipas udhëpërshkruesit J. Miler, në vitin 1838, Janjeva kishte 100 shtëpi me 570 banorë shqiptarë.[18] (Der Flecken von Janjevo hat 150 katholishe Hauser mit 1720 seelen, 22 albanisisch-muhammedanische und 20 muhammedanisehe zigeunerhauser). Ndërsa, sipas Gilferdingut në vitin 1857, Janjeva kishte vetëm popullsi shqiptare, pjesërisht të besimit katolik e pjesërisht të atij myslimanë.[19]

Në sallnamen e Vilajetit të Kosovës të vitit 1887/8 është e regjistruar shkolla për nxënës latinë me 39 nxënës. Kurse, në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1896 (1314 h) dhe të vitit 1900 (1318 h) është i regjistruar me emrin Janova.

Janjeva në fund të shek. XIX kishte 400 shtëpi (320 kroate katolike (autori i quan serbe), 60 shqiptare e 20 rome.[20](Në vitin 1900 kishte 400 shtëpi, nga të cilat 306 latine dhe 75 muhamedane (muhaxhire), kishte edhe disa shtëpi vllahe e rome.[21]

Pas sundimit osman, treva e Janjevës, sikurse edhe trevat e tjera shqiptare, në tetor të vitit 1912 pushtohet nga ushtria serbe. Serbia menjëherë vendos pushtetin e vet administrativ dhe ushtarak. Janjeva bëhet qendër e komunës me të njëjtin emër,

16 ASCPF. Sacg. v. 792, f.150; Frok Zefi, Arqipeshkvnij, fq. 154-155.

17 A. Urosević, Janjevo, fq. 189.

18 Mr. Bedrush Shehu, Një raport i J. Myllerit për Kosovën në vitin 1838, Kosova, 5, IHK, Prishtinë, 1976, fq.74.

19 F. Gilferding, Putovanje po Hercegovini, Bosni i Staroj Srbiji, Sarajevo, 1972.

20 Todor Stanković, Putne beleške po Staroj Srbiji 1871-1898, Beograd, 1910. fq. 93.

21 B. Nušić, Kosovo, N. Sad, 1903, fq. 235.

në kuadër të Rrethit të Graçanicës, përkatësisht të Qarkut të Kosovës. Në kuadër të Janjevës, e cila sipas regjistrimit të vitit 1913, kishte 2.827 banorë, ishin edhe Shashkoci i Epërm më 60 banorë, Teqja me 74 banorë, Honroci me lagjet Brus, Peshter dhe Shar me 231 banorë, Bukovica me 36 banorë dhe Vogoçica me 31 banorë.

Pushteti serb i filloi dhunën, terrorin etj. ndaj popullatës shqiptare, siç ishin masat e çarmatimit, ndërrimit të fesë, trysnisë për shpërngulje të shqiptarëve për në Shqipëri, Turqi e gjetiu etj. Nga Janjeva dhe rrethina e saj, në këtë kohë u shpërngulën një numër i madh i banorëve shqiptarë.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, treva e Janjevës pushtohet nga ushtria bullgare, ku pozita e popullatës aspak nuk u përmirësua. Në vitin 1918, kjo trevë u ripushtua nga Mbretëria SKS. Menjëherë filloi faza e dhunës dhe terrorit ndaj popullatës shqiptare, trysnia për shpërngulje etj. Nga aspekti administrativ, Janjeva mbeti prapë komunë në suazën e Rrethit të Graçanicës.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore Janjeva, sikurse viset tjera të kësaj treve, bie nën sundimin italian. Pas kapitullimit të Italisë në vitin 1943, bie nën sundimin gjerman. Janjeva në këtë kohë ishte në kuadër të Prefekturës së Prishtinës.

Pas mbarimit të luftës, në Janjevë formohet Këshilli Nacionalçlirimtar, i cili në vitin 1946 e ndërron emrin në Këshilli Popullor i Vendit. Janjeva ishte në kuadër të Rrethit të Sitnicës, i cili është formuar në vitin 1947 dhe suprimohet me ndryshimet administrativo-territoriale në vitin 1955. Atëherë, kjo trevë hynë në kuadër të Rrethit të Prishtinës.

Në vitin 1981 Janjeva kishte 754 shtëpi me 5096 banorë (1062 shqiptarë, 20 serbë, 97 turq, 3900 të tjerë – kroatë).

Më fillimin e luftës në Kroaci, për shkak të gjendjes së krijuar politike, dhe më vonë shumë familje kroate janë shpërngulur nga Janjeva dhe janë vendosur kryesisht në Kroaci.

Sipas shënimeve të marra gjatë vizitës së fshatit më 11.6.2001 kishte: 400 familje shqiptare me rreth 2500 banorë, 350 shtëpi (shumica të pabanuara) kroate me 370 banorë kroatë, 40 shtëpi rome me 240 banorë.

Në Janjevë deri me tani janë zbuluar 5 epitafe në gjuhën osmane:

Vendi i origjinës

Xhamia e Janjevës

Viti sipas kalendarit gregorian

1593

Gjendja momentale

I dëmtuar

Varri nr. 5.1

Kitabeja në origjinal:

بن محمد (...) المرحوم.
على الياس شيخ
روحنه الفاتحه
سنه ١٠٠٢

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm ...
bin Mehmed
Şeyh Ali ilyas
Rûhuna el-Fâtiha
Sene 1002

Përkthimi në gjuhën shqipe:

I mëshiruari ...,
i biri i Mehmetit
Shejh Ali Iljasi,
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë.
Viti 1002

Vendi i origjinës
Janjevë
Viti sipas kalendarit gregorian
1612
Gjendja momentale
E mirë

Varri nr. 5.2

Kitabeja ne origjinal:
المرحوم حسين بن عبدلله
سنه ١٠٢١

Kitabeja e transkriptuar:
El-merhûm Hüseyin
bin Abdullah
Sene 1021

Përkthimi në gjuhën shqipe:
I mëshiruari Hysejni,
i biri i Abdullahut.
Viti 1021

Vendi i origjinës

Janjevë

Viti sipas kalendarit gregorian

1774

Gjendja momentale

E mirë

Varri nr. 5.3

Kitabeja në origjinal:

المرحوم المغفور
المحتاج الى رحمت
الغفور قورد
سپاهى بن حسين
روحنه الفاتحه
سنه ١١٨٨

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm el-mağfûr
El-muhtâc
ilâ-rahmeti'l-Gafûr
Kurt Sipahi bin Hüseyin
Rûhuna el-Fâtiha
Sene 1188

Përkthimi në gjuhën shqipe::

I ndjeri, I faluri (nga Zoti),
Nevojtarë për mëshirën
e Gjithëfalësit
Kurt Spahiu,
i biri Hysejnit.
Viti 1188

Vendi i origjinës
Janjevë
Viti sipas kalendarit gregorian
1848
Gjendja momentale
E mirë

Varri nr. 5.4

Kitabeja në origjinal:

هوالخلاق الباقي
المرحوم المغفور
يانوه لى
مرتضي
بن ابوبكر
روحنه فاتحه
سنه ١٢٦٤

Kitabeja e transkriptuar:

Huve›l-Hallâku›l-Bâkî
El-merhûm el-mağfûr
Yanovalı Murtezâ
bin Ebû Bekir
Rûhuna Fâtiha
Sene 1264

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu) është Krijues i
Përhershëm!
I mëshiruari dhe i faluri
(nga Zoti).
Murtezi, i biri i Ebubekirit
nga Janjeva.
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë.
Viti 1264

Vendi i origjinës

Janjevë

Viti sipas kalendarit gregorian

1877

Gjendja momentale

E mirë

Varri nr. 5.5

Kitabeja në origjinal:

هو
المرحوم والمغفور
حليل بن محمد
روحنه الفاتحه
سنه ١٢٩٤

Kitabeja e transkriptuar:

Huve
El-merhûm ve el-mağfûr
Halil bin Mehmed
Rûhuna el-Fâtiha
Sene 1294

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu)!
I mëshiruari dhe i faluri
(nga Zoti).
Halidi i biri i Mehmetit.
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë.
Viti 1294

6. Llukari

Vendbanim kodrinor-malor që shtrihet në një luginë të gjatë, rreth 4 km në verilindje të Prishtinës. Është i ndarë në katër lagje të mëdha.

Sipas disa thënieve - legjendës, fshati Llukar e Kolovicë në të kaluarën ishin Makovci i Poshtëm. Me vdekjen e Kolës, vëllait të Makës, e shoqja e tij mbetet e ve dhe, sipas emrit të kësaj të veje, mbetet edhe emri i fshatit. E veja e Kolës, përkatësisht Kolovicë, që vazhdon ta ketë këtë emërtim edhe sot. Ndërsa, Lugari, derisa ishte mëhallë e Prishtinës, pasuria tokësore nis e shtrihet në Makovc të Poshtëm. Kështu këto toka, me kohë, u quajtën Arat e Llukarasve, përkatësisht Lugar. Sipas gojëdhënës thuhet se Lluka, Maka, Kola, Grasha e Radashi ishin vëllezër të një gjaku, që gjithnjë e ruajtën një vazhdimësi të shtrirjes së tyre territoriale.....[1]

Treva e Lugarit ka një të kaluar të dëshmuar me gjetje arkeologjike. Ajo ishte trevë e pasur me burime të mjaftueshme natyrore të ujit. Një pjesë e Prishtinës furnizohej me ujë të pijshëm nga këtu. Këtë e dëshmojnë gypat prej baltës së pjekur të vijës së dyfishtë, që zbriste në qytet. Lugari kishte ujësjellësin e vet. Në lokalitetin e këtij fshati janë gjetur edhe gjurmë të vjetra të kulturës materiale, si 4 sëpata të metalta, një sëpatë lufte, një kandar, veriga të oxhakut etj. të kohërave të vjetra, që dëshmojnë lashtësinë e vendbanimit.[2]

Llukari ishte mëhallë e Prishtinës, e cila në vitin 1477 i kishte 28 shtëpi, pra 28 kryefamiljarë, 2 kryefamiljare të veja dhe 3 muxheride.[3] Në regjistrimin e vitit 87-1486, Lugari si mëhallë e krishtere e Prishtinës kishte 31 shtëpi hane, 5 shtëpi mucerret dhe 5 shtëpi bive.[4] Më vonë sipas regjistrimit të vitit 74-1566, Lagjja "Llukar" kishte më pak shtëpi – 27, kurse muxheride kishte 6.[5] Në defterët osmanë është regjistruar vendbanimi Makoci i Epërm dhe Makoci i Poshtëm. Si duket një pjesë e Llukarit është quajtur Makoci i Poshtëm.

Si vendbanim me këtë emër është i regjistruar në një hartë austriake, të hartuar në bazë të shënimeve të vitit 1689. Pas luftërave austro-turke të viteve 1687-89 si dhe murtajës, një pjesë e popullatës së Llukarit bartet në fshatrat malore të Gallapit, si në Radashec e Grashticë. Në fund të shek. XVIII, kjo popullatë filloi të kthehej në trojet e veta. Ndërkohë disa banorë të këtij fshati ishin të regjistruar në vitet 1765 dhe vonë në katasihun e Deviçit. Në këtë periudhë, përkatësisht në fillim të viteve 1800, ose në mbarim të viteve 1780-99, Lugari kishte 4 familje me katër kryefamiljarë[6]

---

1 Ali Berisha, Monografi, Bashkia e Llukarit, Prishtinë, 2000, I, fq. 12 dhe 288-289.

2 Po aty, fq. 334-341.

3 Dr. Adem Handzic, "Simpoziumi për Skënderbeun", mbajtur më 9-12 maj të vitit 1968, Prishtinë, 1969; Muhamed Tërrnava, "Onomastika e Kosovës", Prishtinë, 1977, fq. 111.

4 Tapu ve kadastro umum mudurlugunum arsivi Ankara, deft. nr. 124; Marrë nga Libri i cituar i A. Berishës, fq. 63.

5 Muhamed Terrnava: "Popullsia e Prishtinës në gjysmën e dytë të shekullit XVI", Onomastika e Kosovës, fq. 121; A. Berisha, Monografia e cituar, fq. 64.

6 Ali Sh. Berisha, Bashkia e Llukarit, v. e c., , fq. 70.

Me këtë emër është i regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1896 (1314 h) dhe të vitit 1900 (1318 h).

Nga ky vendbanim janë shpërngulur disa familje në Prishtinë e gjetiu.

Në vitin 1913 fshati kishte 166 banorë, ndërsa në vitin 1921 kishte 18 shtëpi me 197 banorë. Në regjistrimin e vitit 1981 kishte 79 shtëpi me 646 banorë shqiptarë, ndërsa në vitin 1996 kishte 140 shtëpi me 1381 banorë. Gjatë luftës së agresorit serb ky fshat pësoi shumë si në banorë ashtu edhe në infrastrukturë dhe objekte ndihmëse dhe banimi.[7]

Sot vendbanim Llukar gati është bashkuar me Prishtinën dhe është shndërruar në një vendbanim modern, jo larg Prishtinës, në një luginë pitoreske.

Në këtë vendbanim deri me tani janë zbuluar 5 epitafe në gjuhën osmane:

7 Shif: Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtina . . ., v. e c., fq. 150-152.

Vendi i origjinës
Llukar
Viti sipas kalendarit gregorian
1849
Gjendja momentale
I dëmtuar

Varri nr. 6.1

Kitabeja në origjinal:

المرحوم المغفور
ياشاربن عبدالفتاح
روحنه الفاتحه
سنه ١٢٦٦

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm el-mağfûr
Yaşar bin Abdülfettâh
Rûhuna Fâtiha
Sene 1266

Përkthimi në gjuhën shqipe:

I mëshiruari dhe i faluri
(nga Zoti).
Jashari, i biri i
Abdylfetahut.
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë.
Viti 1266

Vendi i origjinës

Llukar

Viti sipas kalendarit gregorian

1849

Gjendja momentale

E mirë

Varri nr.6.2

Kitabeja në origjinal:

هوالخلا ق الباقى
المرحوم المغفور
مصلى بن شريف
روحنه الفاتحه
سنه١٢٦٦

Kitabeja e transkriptuar:

Huve'l-Hallâkü'l-Bâkî
El-merhûmü'l-mağfûr
Musli bin Şerif
Rûhuna el-Fâtiha
Sene 1266

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu) është Krijuesi i Përhershëm!
I mëshiruari dhe i faluri,
Musliu, i biri i Sherifit.
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë
Viti 1266

Vendi i origjinës
Llukar
Viti sipas kalendarit gregorian
1850
Gjendja momentale
I thyer

Varri nr. 6.3

Kitabeja në origjinal:

المرحوم المغفور
عباس بن مراصور
روحنه الفاتحه
سنه ١٢٦٧

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm el-mağfûr
Abbâs bin Mirasor
Rûhuna el-Fâtiha
Sene 1267

Përkthimi në gjuhën shqipe:

I mëshiruari dhe i faluri
(nga Zoti),
Abasi, i biri i Mirasorit.
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë.
Viti 1267.

Vendi i origjinës

Llukar

Viti sipas kalendarit gregorian

1865

Gjendja momentale

I dëmtuar

Varri nr. 6.4

Kitabeja në origjinal:

المرحومة و المغفورة
حوا بنت عبدالفتاح
روحنه الفاتحه
سنه ١٢٨٢

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûme ve el-mağfûre
Havvâ bint-i Abdülfettâh
Rûhuna el-Fâtiha
Sene 1282

Përkthimi në gjuhën shqipe:

E mëshiruara dhe e falura
(nga Zoti).
Hava, e bija e
Abdulfetahut.
Për shpirtin e saj këndo
Fâtihanë.
Viti 1282

Vendi i origjinës
Llukar
Viti sipas kalendarit gregorian
1889
Gjendja momentale
I dëmtuar

Varri nr. 6.5

Kitabeja në origjinal:
المرحوم المغفور
خليل بن مرتضى
روحنه فاتحه
سنه ١٣٠٧

Kitabeja e transkriptuar:
El-merhûm el-mağfûr
Halil bin Murtezâ
Rûhuna Fâtiha
Sene 1307

Përkthimi në gjuhën shqipe:
I mëshiruari dhe i faluri,
Halili, i biri i Murtezait.
Për shpirt të tij këndo një
Fâtiha.
Viti 1307

7. Sllovia

Shtrihet rrëzë malit Zhegovc, 8 km në lindje të Lypjanit. Është vendbanim i tipit të grumbulluar, në formë të zgjatur në një luginë, përveç një lagje Bytyçi që është në anën e kundërt të kodrës, afër fshatit Smollushë dhe disa shtëpive rreth fshatit.[1]

Është një prej vendbanimeve më të vjetra të kësaj ane. Lokaliteti i vjetër i këtij vendbanimi është shtrirë në vendin Oborrjani, në lindje të fshatit të sotëm, afër malit. Aty ka qenë një kishë e vjetër iliro-shqiptare. Thuhet se serbët kanë dashur ta përvetësonin. Kanë reaguar popullata shqiptare, duke u thënë: "po e thurni kishën e huaj". Aty ka pasur edhe gjurmë të kulturës materiale të ndërtimit. Po ashtu, lokaliteti i vjetër ka qenë edhe në vendin Manastiri, në fund të Çukës së Vogël, 3 km në lindje të fshatit. Aty ka ekzistuar një manastir i vjetër dhe gjithashtu është ruajtur edhe toponimi Kroni i Kallugjerit. Ka edhe varreza të moçme, siç janë ato afër shkollës, në kodër, në Llazina, nën Zabelin e Sadrisë.[2] Në malet e afërta ka edhe Samakova, shlakë, gurë të xeheve, që dëshmojnë se aty është shfrytëzuar dhe shkrirë xehja. Sipas gojëdhënës, flitet se prej fshatit Sllovi e deri në Novobërdë ishte vendbanim i dendur aq sa dhe macja ka mundur të ecte nëpër mure, gardhiqe e kulme të shtëpive.

Në dokumentet e shkruara përmendet në dy kartat e mbretit dhe të perandorit Stefan Dushanit, në vitet 1331 dhe 1347, dhënë manastirit të Hilandarit. Përmendet edhe në krisobulën e Vuk Brankoviqit të shkruar ndërmjet viteve 1389 dhe 1392 dhënë manastirit të Hilandarit, kartën e konteshës Milica më 1395.[3]

Si vendbanim me emrin Sllovina është i regjistruar edhe në defterin kadastral të Kazasë së Novobërdës të vitit 1498, sipas të cilit kishte 3 kryefamiljarë, 6 të vejë dhe 1 merzë.[4]

Si duket, një kohë ky vendbanim ishte i braktisur dhe rithemeluar prapë si vendbanim. Në të vendosen familjet shqiptare dhe serbe nga fshatrat e ndryshme të Kosovës. Kanë jetuar edhe disa familje rome.

Në këtë vendbanim dhe afër tij u vendosën disa familje shqiptare muhaxhire të dëbuara nga Sanxhaku i Nishit në vitin 1877/78, siç ishin Bregovinët (në Llazishta), Kopranët, Raçët, pastaj Vllahinjët, Dubovcët, Kordincët, Kupinët, Pollomët dhe Klisuricët.[5]

Si vendbanim është i regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1894 (1314 h) dhe të vitit 1900 (1318 h).

Shumë familje nga ky vendbanim prej vitit 1913 janë shpërngulur nga ky vendbanim dhe janë vendosur në Turqi.

---

1 Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Lypjani 5, Prishtinë, 2003, fq. 163-166.

2 E njëjtë.

3 St. Novaković, Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka, Beograd, 1912, fq. 418-423; Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, Vëllimi II, Shek. VII-XV, Tiranë, 1962, fq. 130; Zadužbine Kosova, fq. 526.

4 Ilijaz Rexha, Regjistri i vendbanimeve dhe i popullsisë së Kazasë së Novobërdës sipas Defterit Kadastral nr. 28, Vjetari, Prishtinë, 2002.

5 Sabit Uka, Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë 1878-1912, Pjesa e Parë, 2, Prishtinë, 1994, fq. 129.

Afër fshatit pushteti agrar, pas vitit 1924, kishte vendosur disa familje kolone sllave, në tokat e shqiptarëve, ndërsa disa ishin vendosur në tokat e blera, kryesisht të popullatës shqiptare të shpërngulur. Këta ishin nga Shumadia, Zhupa e Siriniqit etj.

Sipas B. Nushiqit, rreth vitit 1900 Sllovia kishte 60 shtëpi me rreth 450 banorë, prej të cilëve, 6 shtëpi serbe me 48 frymë, 15 shtëpi rome e të tjerat - 39 shqiptare.[6] Ndërsa, në vitin 1981, fshati kishte 406 shtëpi me 3013 banorë (2595 shqiptarë, 401 serbë, 2 malazez, 15 të tjerë).

Më 16 prill të vitit 1999, agresori serb në këtë vendbanim bëri masakër, duke vrarë e masakruar 44 shqiptarë. Të ekzekutuarit ishin civilë - burra, gra, fëmijë, pleq e të rinj, nga mosha 5 deri në 92-vjeçare.

Në lokalitetin e këtij vendbanim deri me tani janë zbuluar 2 epitafe në gjuhën osmane:

6 B. Nušić, Kosovo, Novi Sad, 1903, fq. 257.

Vendi i origjinës

Sllovi

Viti sipas kalendarit gregorian

1816

Gjendja momentale

I dëmtuar

Varri nr. 7.1

Kitabeja në origjinal:

المرحوم المغفور
زكربن خيري
روحيچون الفاتحه
سنه ١٢٣١

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm el-mağfûr
Zekir bin Hayri
Rûhı-çün el-Fâtiha
Sene 1231

Përkthimi në gjuhën shqipe:

I mëshiruari dhe i faluri,
Zeqiri, i biri i Hajriut.
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë.
Viti 1231

Vendi i origjinës
Sllovi
Viti sipas kalendarit gregorian
1915
Gjendja momentale
I dëmtuar

Varri nr. 7.2

Kitabeja në origjinal:

المرحوم
بيرام حسين
روحنه فاتحه
سنه ١٣٣١

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm
Bayram Hüseyin
Rûhuna Fâtiha
Sene 1331

Përkthimi në gjuhën shqipe:

I mëshiruari,
Bajram Hysejni.
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë.
Viti 1331

8. Truda

Shtrihet rreth 6-7 km në veri të Prishtinës. Është vendbanim i tipit të grumbulluar. Lokaliteti i vjetër i fshatit shtrihet pas kodre, 3 km larg në verilindje nga lokaliteti i sotëm. Atje janë edhe varrezat e moçme, te vendi Lugu i Thiut, ku sot është pjesë malore. Janë ruajtur themelet e kishës së vjetër, në rrugën e vjetër, në dalje të Gurkuqit, që sot njihet si Lugu i Kishës. Edhe në pjesën e re është ruajtur mikrotoponimi Kroni i Kishës.[1]

Në dokumentet e shkruara përmendet në defterin kadastral turk të vitit 1455 dhe, sipas tij, kishte 33 shtëpi, 4 beqarë e 5 veja.[2]

Si vendbanim me emrin Trub është i regjistruar në një hartë austriake të hartuar në bazë të shënimeve të vitit 1689.

Banorët e sotëm janë të fisit Shalë, të ardhur para 265 vjetësh nga fshati ish Selac, tani Belatajë i Shalës së Bajgorës. Ata, kur vijnë në pjesën e vjetër të fshatit, sipas tregimit të pleqve të përcjellë brez pas brezi, thuhet se aty kishin gjetur një ahur dhe një kosh misri, pasi popullata e kishte braktisur këtë vendbanim. Ndërsa, nga ajo kohë është ruajtur toponimi Bunari i Manit, që dëshmon se aty dikur kishin jetuar banorë para familjes Shala.[3]

Në këtë vendbanim shqiptar, në vitin 1878 u vendosën familjet muhaxhire shqiptare - Shushnjakët (të cilët deri në vitin 1912 kishin qëndruar në Ribarin e Vogël të Lipjanit dhe Dobratiqët të dëbuar nga Sanxhaku i Nishit.[4]

Në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1896 (1314 h) dhe të vitit 1900 (1318 h) është i regjistruar si vendbanim.

Nga ky vendbanim shpërngulen në Turqi: në vitin 1924 familja Bajgora (Sheqa, Behrami, Meti) dhe Sefa i Zeçës në kohën e Mbretësisë Jugosllave, familja e Ajet Pajazitit (në vitet e pesëdhjeta). Këta persona kishin prona të mëdha të tokës. Këto prona i mori pushteti agrar dhe ua ndau kolonëve nga fshati i afërt Bardhosh, kurse një pjesë të vogël të tokës e shitën me çmim simbolik. Në vitin 1922 këtu u vendosën dy familje kolone nga Serbia.

Para fillimit të Luftës së Dytë Botërore fshati kishte 20 shtëpi shqiptare dhe dy serbe. Në vitin 1913 ky vendbanim me lagjen Lebanë kishte 230 banorë, ndërsa në vitin 1921 si vendbanim i veçantë kishte 34 shtëpi më 266 banorë. Më vonë sipas regjisrimit të vitit 1981 kishte 64 shtëpi më 520 banorë, prej tyre 5 serbë. Në fillim të vitit 1999 kishte 83 shtëpi më 626 banorë shqiptarë. Fshati gjatë luftës së agresorit serb pësoi duke u shkatërruar e dëmtuar 13 shtëpi dhe dy banorë kanë pësuar.

Ky vendbanim, në të cilin jeton popullata shqiptare e fisit Shalë, ka përjetuar një transformim të theksuar, për shkak të afërsisë me Prishtinën.

Në lokalitetin e këtij vendbanimi deri me tani janë zbuluar 2 epitafe në gjuhën osmane:

1 Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtina . . ., v. e c., fq. 126-128.
2 Obast Brankovica, v. e c., fq. 85.
3 Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtina . . ., v. e c., fq. 126-128.
4 A. Urošević, Kosovo, v. e c., fq. 309.

Vendi i origjinës
Trudë
Viti sipas kalendarit gregorian
1837
Gjendja momentale
I dëmtuar

Varri nr. 8.1

Kitabeja në origjinal:

المرحم المغفور
زينل بن دمير
روحنه الفاتحه
سنه ١٢٥٣

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm el-mağfûr
Zeynel bin Demir
Rûhuna el-Fâtiha
Sene 1253

Përkthimi në gjuhën shqipe:

I mëshiruari dhe i faluri,
Zejneli, i biri i Demirit.
Për shpirtin e tij këndo
Fâtihanë.
Viti 1253

Vendi i origjinës

Trudë

Viti sipas kalendarit gregorian

Mungon

Gjendja momentale

I betonuar

Varri nr. 8.2

Kitabeja në origjinal:

هي
المرحومة
فتحيه بنت
مصطفى
روحنه فاتحه

Kitabeja e transkriptuar:

Hiye
El-merhûme
Fethiye bint-i
Mustafa
Rûhuna Fâtiha

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ajo, e mëshiruara,
Fet'hija, e bija e
Mustafasë.
Për shpirtin e saj këndo
Fâtihanë.

9. Prugovci

Vendbanim që shtrihet rreth 9-10 km në veriperëndim të Prishtinës. Është i ndarë në pesë lagje, të cilat janë larg njëra prej tjetrës së paku një km. Lagjet e këtij vendbanimi: Mëhalla e Mullinit (Mëhalla e Parë) dhe katër lagje të tjera, të cilat më parë quheshin sipas familjeve të mëdha në to, ndërsa tani, meqenëse, familjet janë të përziera, quhen Mëhalla e Dytë, Mëhalla e Tretë, Mëhalla e Katërt dhe Mëhalla e Pestë. Në këto mëhalla jetojnë familjet vendëse Berisha, Kelmendi, Rrustollët etj. dhe ato muhaxhire, të dëbuara nga Sanxhaku i Nishit në vitin 1877/78, siç janë: Kojçiqi, Dragusha, Shala, Statofci, Konjuhi, Pllana, Visoka, Sfarça, Spanca, Kaçuri etj.[1]

Lokaliteti i këtij fshati, i shtrirë kryesisht rreth lumit Llap, ishte i banuar mjaft herët, por nuk janë bërë gërmime arkeologjike. Mirëpo, mikrotoponimet e ruajtura si dhe gjetjet arkeologjike të rastit, dëshmojnë se ky lokalitet ishte i banuar nga kohërat e hershme, si p.sh. Trojet, Arat e Kishës (në lagjen e katërt), Trojet dhe Arat e Virgjeve, Arat Naltë, në Lagjen e dytë janë gjetur gjurmë të vendbanimit, si thëngjij të zjarreve, gëzhoja të veve, filxhanë, vorba etj.[2]

Në dokumentet e shkruara, në Defterin kadastral të Vilajetit Vëllk të vitit 1455 përmendet ky vendbanim, i cili ishte mjaft i madh dhe kishte 68 shtëpi, 7 të veja dhe 5 beqarë.[3] Në defterin kadastral të Sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 74-1566 kishte 25 shtëpi, 9 beqarë e 1 çift.[4]

Në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1896 (1314 h) është i regjistruar me emrin Pergofça, si dhe në atë të vitit 1900 (1318 h) është i regjistruar me emrin Pergofc.

Banohej me popullatë autoktone shqiptare, por me një numër të vogël të banorëve. Në vitin 1877/78 këtu u vendosën më se 19 shtëpi, përkatësisht pjesëtarët e 13 vëllazërive shqiptare muhaxhire[5].

Gjatë Mbretërisë Jugosllave në këtë vendbanim u sollën dy familje kolone sllave. Në vitin 1921 xhandarmëria serbe dogji 7 shtëpi të familjes Kaçuri. Nga ky vendbanim, më tepër se 15 familje shqiptare u shpërngulën në Turqi, në periudha të ndryshme.

Ky vendbanim në vitin 1913 kishte 422 banorë, ndërsa në vitin 1921 kishte 46 shtëpi më 342 banorë. Në regjistrimin e vitit 1981 kishte 187 shtëpi me 1664 banorë shqiptarë, ndërsa në vitin 1999 fshati kishte 260 shtëpi më 1620 banorë.

Sot ky vendbanim, që shtrihet pranë lumit Llap, falë pozitës së mirë gjeografike, është shndërruar në njërin ndër fshatrat më bashkëkohorë të rajonit dhe është rritur numri i banorëve në masë ta madhe. Lagjet pothuajse janë ngjitur me njëra-tjetrën.

Në lokalitetin e këtij vendbanimi deri më tani janë zbuluar 5 epitafe në gjuhën osmane:

---

1 Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosoves, Prishtina . . . ., v. e c., fq. 200-202.

2 E njëjtë.

3 Oblast Brankovića, fq. 236-237.

4 S. Pulaha, Popullsia ....., v. e c., fq. 682.

5 A. Urošević, Kosovo, v. e c., fq. 274; Dr. S. Uka, Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë 1878-1912, Pjesa 2, Prishtinë, 1994, fq. 231-232.

Vendi i origjinës

Prugovc

Viti sipas kalendarit gregorian

1797

Gjendja momentale

I dëmtuar

Varri nr. 9.1



Kitabeja në origjinal:

المرحوم والمغفور
سليمان بن مصطفى
روحيچون
الفاتحة
سنه ١٢١٢

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm ve el-mağfûr
Süleyman bin Mustafa
Rûhı-çün
El-Fâtiha
Sene 1212

Përkthimi në gjuhën shqipe:

I mëshiruari dhe i faluri,
Sulejmani,
i biri i Mustafasë.
Për shpirtin e tij këndo
Fatihanë.
Viti 1212

Vendi i origjinës
Prugovc
Viti sipas kalendarit gregorian
1801
Gjendja momentale
I dëmtuar

Varri nr. 9.2

Kitabeja në origjinal:

المرحوم والمغفور
قورطو بن آدم
روحيچون
الفاتحه
سنه ١٢١٦

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm ve el-mağfûr
Kurtu bin Âdem
Rûhı-çün
El-Fâtiha
Sene 1216

Përkthimi në gjuhën shqipe:

I mëshiruari dhe i faluri,
Kurti, i biri i Ademit.
Për shpirtin e tij këndo
Fatihanë.
Viti 1216

Vendi i origjinës

Prugovc

Viti sipas kalendarit gregorian

1892

Gjendja momentale

E mirë

Varri nr. 9.3



Kitabeja në origjinal:

المرحوم والمغفور
بكتاش روحيچون
الفاتحه
سنه ١٣١٠

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm ve el-mağfûr
Bektaş rûhı-çün
El-Fâtiha
Sene 1310

Përkthimi në gjuhën shqipe

I mëshiruari dhe i faluri,
Bektashi.
Për shpirtin e tij këndo
Fatihanë.
Viti 1310

Vendi i origjinës
Prugovc
Viti sipas kalendarit gregorian
1904
Gjendja momentale
I dëmtuar

Varri nr. 9.4

Kitabeja në origjinal:

مرحوم
حزیربن سعید
روحنه فاتحه
سنه ۱۳۲۲

Kitbeja e transkriptuar:

Merhûm
Hazir bin Sa'id
Rûhuna Fâtiha
Sene 1322

Përkthimi në gjuhën shqipe

I mëshiruari,
Haziri, i biri i Seidit.
Për shpirtin e tij këndo
Fatihanë
Viti 1322

Vendi i origjinës

Prugovc

Viti sipas kalendarit gregorian

1921

Gjendja momentale

I dëmtuar

Varri nr. 9.5

Kitabeja në origjinal:

المرحوم
اسلام خاريس
روحنه فاتحة
سنه ١٣٤٠

Kitbeja e transkriptuar:

El-merhûm
İslam Hâris
Rûhuna Fâtiha
Sene 1340

Përkthimi në gjuhën shqipe

I mëshiruari,
Islam Harisi.
Për shpirtin e tij këndo
Fatihanë.
Viti 1340

10. Podujeva

Është vendbanim, përkatësisht qendër rajonale e administrative (komunale) në fushëgropën e Llapit. Shtrihet në verilindje të Kosovës. Në lokalitetin e Podujevës janë gjetur gjurmë të vendbanimit të vjetër, e sidomos në lokalitetet e afërta, siç ishin vendbanimet e vjetra dardane Vendenis dhe Labrion. Në oborrin e xhamisë pranë lumit Ibër, në hyrje të Podujevës një altar i punuar prej guri.[1]

Në dokumentet e shkruara përmendet në defterin kadastral osman të vitit 1455 dhe kishte 43 shtëpi dhe 6 beqarë.[2] Ndërsa, në regjistrin sumar të Sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1487 kishte 77 shtëpi, 22 të pamartuar, 2 të veja.[3] Në defterin kadastral të Sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 74-1566 kishte 80 shtëpi e 26 beqarë.[4] Në një dokument të vitit 1660 që ruhet në Arkivin e Dubrovnikut ruhen shënimet për tregtarët dubrovnikas që blenin lesh në Podujevë.

Në një hartë gjeografike austriake të hartuar në bazë të shënimeve të vitit 1689 është regjistruar si vendbanim, sikurse të tjerat. Në vitin 1783 përmendet si fshati Podujevë,[5] pastaj në vitin 1840 si Podujevë, etj.

Për shkak të pozitës ky vendbanim rritej mjaft shpejt. Mirëpo, disa herë nga pushtuesit e ndryshëm Podujeva u plaçkit dhe u rrënua, si në vitet 1690, 1736 dhe 1877. Por, përkundër kësaj qyteti u ngrit sërish. Rrënim pësoi edhe më 1912, 1916 dhe 1944. Nga fundi i shek. XIX Sylejman Pasha e bëri meremetimin e rrugës Prishtinë-Podujevë -Dumnicë. Qendra e Nahijes së Llapit ishte Podujeva. Aty u ndërtuan mullinj, u hapen dyqane, u ndërtuan shtëpia të reja dhe u zgjëruan lagjet e qytetit. Pas ndërtimit të Merçezit, ky vendbanim u bë qendër e rëndësishme e ushtrisë osmane.[6]

Merçezi (kazermë e ushtrisë e cila gjendej në kodrizën në lindje të qendrës së tashme të qytetit), ishte si fortifikatë e rrethuar më mure të larta, me dyer të mëdha e brenda me dhoma për ushtarë e oficierë. Aty ishte burgu, stacioni i zaptive, ndërsa në një krah me ahurie.

Vërtetë rajoni i Llapit, pra edhe Podujeva ra nën sundimin serb në mes të viteve 1203 dhe 1210, por me saktësi nuk është theksuar viti. Deri në këtë kohë popullsia shqiptare e Llapit gati në tërësi ishin të krishterë të ritit katolik. Dhe në këtë kohë kleri katolik kryesisht ishte shqiptar. Mirëpo, pas rënies së rajonit të Llapit nën sundimin serb klerin katolik shqiptar, por edhe ortodoks i larguan nga kisha në këtë rajon dhe i zëvendësuan me popa ortodoks serbë. Dhe shqiptarët e krishterë të ritit katolik i detyruan me dhunë të pranonin kishën serbe. Nga ana tjetër edhe gjuha shqipe që përdorej në meshë u zëvendësua me gjuhë serbe. Njëherit, edhe kur bëhej kryqëzimi i fëmijve në kishë, popi serb vendoste

1 Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Besiana (Podujeva), 17, Prishtinë, fq. 99-106.

2 Oblast Brankovića, v. e c., fq. 241.

3 Defterët e Sanxhakut të Vushtrrisë të viteve 1477 dhe 1478, që ruhen si kopje ngë Arkivin e Kosovës, të sjellura nga Arkivi i Kryeministrisë së Turqisë në Stamboll, dëshifruar nga prof. dr. Iljaz Rexha.

4 Prof. dr. Ilijaz Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas Defterit të Sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566/74, Vjetari i Arkivit të Kosovës, nr. XXXI-XXXII, Prishtinë, 2004.

5 F. Mihailovic, Isveštaj o putu od Carigrada preko Drača do Beograda, 1783, Spomenik SLXXXII, nr.64, Beograd, 1936; Sergije Dimitrijević, Dubrovački karavani u Južnoj Srbiji u XVII veku, SAN,Istorijski institut, knj.10, Beograd, 1958, fq.114.

6 Dr. Fehmi Pushkolli, Llapi gjatë historisë, Prishtinë, 1998., fq. 384.

edhe për emrat e tyre. Të gjitha këto kishin për qëllim asimilimin e tyre në serbë. Kjo ishte shkak që shqiptarët u irituan që të shkonin në kishë. Këtu qendron esenca e çështjes së fesë ndër shqiptarë dhe për këtë arsye, kur rajonin e Llapit e pushtuan turqit, shqiptarët e pranuan besimin islam. Feja islame në aspektin kombëtar ishte shumë më liberale dhe nuk cenonte gjuhën, doket, zakonet dhe traditën shqiptare.[7]

Në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1896 (1314 h) dhe të vitit 1900 (1318 h.) është i regjistruar si vendbanim me emrin Podjeva.

Pas dëbimit të shqiptarëve nga trevat e Toplicës, Pustarekës, Jabllanicës etj. në vitet 1877-1878 këtu gjeten strehim shumë familje shqiptare muhaxhire. Disa familje muhaxhire shqiptare janë vendosur këtu më vonë, të ardhur nga fshatrat e ndryshme.[8]

Duhet theksuar se në këtë qendër, sikurse edhe në tërë trevën e Llapit deri në vitin 1912 nuk kishte asnjë familje serbe e malazeze.[9] Pra, serbët e malazezët këtu erdhen pas vitit 1913 dhe pas Luftës së Parë Botërore. Kështu në këtë lokalitet u vendosën 157 shtëpi.[10] Mirëpo, numri i tyre është shumë më i madh, pasi që shumë familje serbe e malazeze ishin vendosur këtu si nëpunës, xhandarë etj. dhe nuk ishin të regjistruar si kolonë.

Në fund dhe në fillim të shek. XX në Besianë u hap një numër i dyqaneve. Pra, këtu gjatë viteve të fundit të sundimit osman, vijnë disa familje tregtare, sidomos nga Gjakova dhe i hapin dyqanet e veta. Dyqanet e para zunë vend në anën e djathtë të lumit Llap. Këto mbanin duhan, gaz, kryp, bez etj.[11] Sipas rrëfimit të pleqëve, pos këtyre shtëpive në pjesën e djathtë të Llapit – që njiherit sajon pjesën më të vjetër të vendbanimit, pjesa tjetër ka qenë krejtësisht i pabanuar. Këtu janë shtrirë meratë; ledina për kullotjen e bagëtive. Në pjesën e sotme të qendrës së Besianës, te parku dhe permendorja e sotme kanë mrizuar bëgëtia, ndërsa më vonë është bërë treg i bagëtive.

Më 1912 ushtria serbe me topa e rrënoi qytetin e Podujevës. Por, prapë filloi rindërtimi. Më 1915 prapë u plaçkit. Me vendosjen e administratës, pushteti serb në fillim për zyra të rrethit zgjodhi Merçezin, por më 1926, qeveria serbe me qëllim të humbjes së gjurmëve të këtij lokaliteti ajo e rrënoi dhe me gurë të tij në vitin 1927 ndërtoi kishë ortodokse dhe e pyllëzoi këtë lokalitet me pishnaja dhe menjëherë e vuri nën mbrojtje të shtetit.

Nga ky vendbanim janë shpërngulur në Turqi pjesëtarë të shumë familjeve, sidomos familjet shqiptare muhaxhire.

Podujeva sipas disa shënimeve në vitin 1999, kishte rreth 3100 shtëpi me 27.500 banorë shqiptarë, 182 shtëpi serbe e malazeze dhe 48 shtëpi rome. Janë djegur e shkatërruar 413 shtëpi dhe shumë objekte të tjera afariste, ndihmëse, ekonomike etj. të të gjitha nacioaliteteve. Nga ky lokalitet janë vrarë 83 banorë, nga të cilët edhe fëmijë, pleqë, gra, etj. Në vitin 2012 komuna e Podujevës kishte rreth 140.000 banorë, ndërsa qyteti i Podujevës rreth 55.000 banorë.

Podujeva gjatë agresorit serb në vitin 1998-1999 pësoi shumë. U vranë me qindra banorë, madje edhe masakra në familje etj. U rrënuan shumë objekte banimi dhe të tjera.

Në lokalitetin e kësaj qendre komunale deri me tani janë zbuluar 2 epitafe në gjuhën osmane:

---

7 Po aty.

8 Dr. Sabit Uka, Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë 1878-1912, Pjesa e Parë, 2, Prishtinë, 1994, fq. 59-63.

9 K. Ristic, Malo Kosovo, Prishtinë, 1970, fq. 253-255.

10 Dr. M. Obradović, Agrarna reforma i kolonizacija Kosova, Prishtinë, 1981, fq. 248-249.

11 Qazim Lleshi, Podujeva qendër regjionale e Llapit, "Përparimi" , 1-2/1964, Prishtinë, fq. 92.

Vendi i origjinës
Podujevë
Viti sipas kalendarit gregorian
1938
Gjendja momentale
E mirë

Varri nr. 10.1

Kitabeja në origjinal:

١٩٣٨
مرحوم
دبران ابن شاله ابن حسين
روحنه فاتحه
والى پوديه

Kitabeja e transkriptuar:

1938
Merhûm
Dibrân ibn Şâla
ibn Hüseyin
Rûhuna Fâtiha
Podyavalı

Përkthimi në gjuhën shqipe

1938
I mëshiruari,
Dibrani,
i biri i Shalës
të birit të Hysejnit.
Për shpirtin e tij këndo
Fatihanë.
Podujevasi

Vendi i origjinës

Podujevë

Viti sipas kalendarit gregorian

1950

Gjendja momentale

E mirë

Varri nr. 10.2

Kitabeja në origjinal:

١٩٥٠
مرحومه
حوليا
بنت شاله
روحنه
والى پوديه

Kitabeja e transkriptuar:

1950
Merhûme
Hülya
bint-i Şâle
Rûhuna
Podyevalı

Përkthimi në gjuhën shqipe

1950
E mëshiruara
Hylja,
E bija e Shalës.
Për shpirtin e saj
(këndo Fatihanë).
Podujevasi

11. Dumnica e epërme

Dumnica e epërme shtrihet rreth 10 km në veri të Podujevës. Shtëpitë janë të vendosura nëpër kodrina, rrafshira, lugira etj., të ndara në lagje dhe në grupe të shtëpive. Përfshinë një territor të gjërë, nga Dumnica e Poshtme e deri te Pecia, në kufi me Serbinë.

Lokaliteti i fshatit të vjetër është shtrirë në lagjen e Jahollëve (Avdiu). Gjatë lëvrimit të tokës dalin mbeturina të materialit ndërtimor, siç janë tjegulla, tulla, gurë të gdhendur, etj. Jo larg xhamisë së fshatit ekzistojnë Varrezat e Krushqëve. Afër këtij vendbanim ka kaluar rruga e njohur antike Lissus – Naissus.[1]

Në defterët osman, janë të regjistruar tri vendbanime me emrin Dumnicë – e epërme, e poshtme dhe e mesme, që i takojnë nahijesë së Llapit. Këto vendbanime duhet të indetifikohen me vendbanimet e sotme Dumnicë e Epërme dhe Dumnicë e Poshtme. Ndërsa, Dumnica e Mesme, duhet të ketë qenë pjesë e Dumnicës së Epërme, ose disa e ubifikojnë me pjesët e fshatit të afërt Llaushë.

Në dokumentet e shkrura përmendet në defterin kadastral të Vilajetit Vëllk të vitit 1455 me emrin Gorna Dubnica dhe kishte 30 shtëpi, 5 beqarë e 1 të vejë dhe Sredna Dubnica me 20 shtëpi e 5 beqarë.[2] Në defterin kadastral të Sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1477, me emrin Gorna Dubinç, timar i Muhamedit, të birit të Makilos, i takon Llapit kishte 24 shtëpi dhe 4 beqarë, me të ardhura 1823 akçe.

Në defterin tjetër të Sanxhakut të Vushtrrisë, të vitit 1487, me emrin Dibniç Gorna, i takon nahijes së Llapit, timar i Mustafait, reisit të çaushëve të Daut Pashë, kishte 29 shtëpi, 6 beqarë dhe 2 të veja, me të ardhura 2237 akçe. Po në këtë defter ishte regjistruar edhe vendbanimi tjetër me emrin Srednja Dubnica që kishte 10 shtëpi dhe 4 beqarë.[3] Në defterin e vitit 74-1566 me emrin Gorna Dubnica kishte 18 shtëpi, 10 beqarë e 1 e vejë dhe Sredna Dubnica me 17 shtëpi, 3 beqarë e 1 të vejë.[4]

Si vendbanim me emrin Domnica është i regjistruar në një hartë gjeografike austriake në bazë të shënimeve të vitit 1689.

Në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h) dhe të vitit 1896 (1314 h) dhe të vitit 1900 (1318 h) është e regjistruar me emrin Domniçe-i Bala.

Është banuar nga shqiptarë vendës. Pas dëbimit të shqiptarëve muhaxhirë nga Sanxhaku i Nishit më 1878 këtu u vendosën familjet: Rudari, Dabinofci, Igrishta dhe Vërshefci me disa shtëpi. Kanë jetuar edhe familjet Raçi, por kanë kaluar në Dumnicë të Poshtme.

Sipas një harte etnografike të fund shek. XIX dhe fillim të shek. XX, ky vendbanim kishte 35 shtëpi shqiptare. Nga ky fshat disa familje shqiptare pas luftërave ballkanike e më

1 Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Besiana (Podujeva), 17, Prishtinë, fq. 189-192.

2 Defter, Oblast Brankovića,Sarajevo, fq. 304 dhe 339.

3 Defteri sumar i Sanxhakut të Vushtrrisë nr. 22, viti 1487; dr. K. Ristić, Malo Kosovo, fq. 57.

4 Selami Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI, Tiranë, 1984, fq. 684 dhe 687.

vonë shpërngulen më se 20 familje në Turqi (Dabinovcët, Vërshevcët, Igrishtët) e disa të tjera në vende të tjera.

Dumnica e Epërme dhe Dumnica e Poshtme në vitin 1913 kishin 1101 banorë, ndërsa sipas regjistrimit të vitit 1921 vetëm Dumnica e Epërme kishte 42 shtëpi me 309 banorë. Në vitin 1981 ky vendbanim kishte 114 shtëpi me 844 banorë shqiptarë. Para agresionit serb në vit. 1998-99 fshati kishte 98 familje me 810 banorë shqiptarë. Nga sulmet paramilitare, ushtarake e policore janë djegur 68 shtëpi si dhe objekte ndihmëse dhe ekonomike. Janë vrarë 7 banorë (në mesin e tyre 3 vëllezër, një dëshmor.[5]

Në lokalitetin e këtij vendbanimi deri me tani janë zbuluar 2 epitafe në gjuhën osmane:

5 Dr. Jusuf Osmani, Serb Goverment's Crimes in Kosova 1998-1999, Prishtinë, 2016.

Vendi i origjinës
Dumnicë
Viti sipas kalendarit gregorian
1893
Gjendja momentale
E mirë

Varri nr. 11.1

Kitabeja në origjinal:
مالكه بنت
عوقه ١٣١١

Kitabeja e transkriptuar:
Mâlike bint-i
Uka
1311

Përkthimi në gjuhën shqipe:
Malikeja, e bija
Ukës.
Viti 1311

Vendi i origjinës

Dumnicë

Viti sipas kalendarit gregorian

Mungon

Gjendja momentale

I dëmtuar

Varri nr. 11.2

Kitabeja në origjinal:

المرحوم
قيطازبن
زنبر
روحنه

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm
Kaytâz bin
Zünber
Rûhuna

Përkthimi në gjuhën shqipe:

I mëshiruari,
Kajtazi, i biri i
Zynberit.
Për shpirtin e tij

(i betonuar)

Pamje nga Prishtina e vjetër – Çeshmja pranë Xhamisë së Jashar Pashës
Eski Priştine manzarası – Yaşar Paşa Camisi'nin çeşmesi

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

929.55(496.51-25)
Epitafet në gjuhën osmane : deshifrimi dhe përkthimi i tyre në regjionin e Prishtinës / Përgatiten për botim Agron Islami, Selim Selimi, Hatixhe Ahmeti. – Prishtinë : Fakulteti i Studimeve Islame, 2017. – 123 f. : 21 cm.
Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze. – Parathënie : f. 5-6
1.Islami, Agron 2.Selimi, Selim 3.Ahmeti Hatixhe

ISBN 978-9951-583-08-4